

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6064
E enjte, 16 korrik 2020
çmimi 0.40 €

Blokoheh llogaritë e
Telekomit, kërkohet
ndihmë institucionale



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", TIME KADRIJAJ | FAQE 4-5

BE-ja PO TREGOHET E PADREJTË ME KOSOVËN

Deputetët e grupeve të ndryshme parlamentare kanë shfaqur të martën pikëpamjet e tyre për gjendjen në vend sa i përket menaxhimit të pandemisë Covid-19, e kanë kritikuar qeverinë Hoti, por edhe kanë dhënë ide dhe alternativa për menaxhimin e kësaj pandemie. Por, shkaku i mungesës së deputetëve në sallën e Kuvendit është pamundësuar procesi i votimit

të dy rezolutave, pas diskutimit për situatën pandemike. Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka thënë se Kryesia e Kuvendit do të vendosë që këto projektrezoluta të hidhen në votim në një nga seancat e ardhshme. Osmani ka thënë se vendit i duhet një bazë ligjore për luftimin e pandemisë, derisa ka kërkuar nga deputetët të mos bëhen arsye që ky virus të mos luftohet me ligj



Shkruan:
Kudusi LAMA



OPINION

EVROPA NUK ËSHTË MIRË TË GODASË MBI SHENJTËRINË E LUFTËS ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS F. 11

THAÇI EDHE TË ENJTEN DO TA VAZHDOJË INTERVISTIMIN NË HAGË F. 2



MAVRAJ: GJYKATA SPECIALE ËSHTË PROJEKT I THELLË STRATEGJIK PRO RUS F. 3



EKONOMI

NË KOHË TË PANDEMISË, BIZNESI VENDOR UA PAGUAN PAGËN E 13 PUNËTORËVE F. 8

MË 23 KORRIK MBLIDHET KUVENDI, NË SHQYRTIM EDHE PROJEKTLIGJI NË LEXIM TË DYTË PËR BUXHETIN F. 6

SPORT

DUMOSHI: SALLA E SPORTIT NË ISTOG PËRFUNDON NË SHTATOR F. 16

COVID-19 NË KOSOVË: 5 237 RASTE POZITIVE, 2 462 TË SHËRUAR DHE 112 TË VDEKUR



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit janë paraqitur 119 raste të reja me Covid-19 si dhe janë shëruar 32 persona të prekur nga koronavirusi. Sipas këtij Instituti, nga 119 rastet e reja me Covid-19, vetëm në Prishtinë janë paraqitur 63. Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, në një konferencë për media ka thënë se do t'i rrisin kapacitetet për testime me Covid-19. Në Kosovë nga marsi janë paraqitur 5 237 raste me Covid-19, prej tyre 2 462 persona janë shëruar dhe 112 kanë ndërruar jetë

Hoti në Bruksel: Liberalizimi i vizave, nevojë urgjente



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Thaçi edhe të enjten do ta vazhdojë intervistimin në Hagë



ose hedhur poshtë aktakuzat. Presidenti Thaçi në ditën e parë kur është paraqitur në Zyrën e Prokurorisë së Specializuar në Hagë dhe ku ka qëndruar mbi gjashtë orë, e pas daljes nga ajo ka bërë me dije se ka dëgjuar shkëmbimet e teknikaliteteve të ndryshme në mes të avokatit Prosper dhe prokurorëve të çështjeve sqaruese teknike dhe në të njëjtën kohë edhe ato fillestare, të interesimit të prokurorëve për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Para se të hynte në ndërtesën e Prokurorisë së Specializuar për intervistim, Thaçi ka thënë për mediat se beson se nga kjo sfidë do të dalë me sukses. "Sot jam këtu për ta respektuar atë që kam ëndërruar dhe për të cilën kam luftuar. Një Kosovë e lirë e pavarur e bazuar në të drejta të barabarta, shoqëri multietnike dhe sundim të ligjit. Jam i gatshëm të përballem me sfidën e re dhe të ngadhënjej për djalim tim, familjen time, njerëzit e mi dhe shtetin tim. Asnjëri nuk mund ta rishkruajë historinë. Ky është çmimi për liri", ka thënë Thaçi para gazetarëve teksa dëgjoheshin brohoritjet "UÇK, UÇK" dhe "Thaçi, Thaçi" të dhjetëra protestuesve shqiptarë që protestonin para Speciales kundër ngritjes së aktakuzës ndaj tij.

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

HAGË, 15 KORRIK - Ka përfunduar intervistimi i presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit, për ditën e tretë radhazi nga prokurorët e Dhomave të Specializuara në kuadër të Gjykatës Speciale. As pas përfundimit të ditës së

tretë të intervistimit, që sërish ka zgjatur rreth gjashtë orë, presidenti Thaçi nuk ka bërë ndonjë koment pas daljes nga objekti i gjykatës.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të enjten në orën 14:00 do të rikthehet për t'u intervistuar në Prokurorinë e Posaçme në Hagë, e cila trajton pretendimet për krime

të luftës dhe të pasluftës në Kosovë. Më 24 qershor Zyra e Prokurorit të Specializuar ka njoftuar se më 24 prill u ka dërguar Dhomave të Specializuara të Kosovës, me seli në Hagë, një aktakuzë me dhjetë pika për shqyrtim, në të cilën presidenti Thaçi, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli dhe të

tjerë, akuzohen për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe krime lufte.

Presidenti Thaçi më herët ka deklaruar se do të japë dorëheqje nga posti i presidentit nëse aktakuza ndaj tij konfirmohet. Gjykatësi i procedurës paraprake ka maksimum gjashtë muaj, nga muaji prill, për t'i konfirmuar

Ali Ahmeti: Presim një fitore në kompleksin shqiptar

SHKUP, 15 KORRIK - Qytetarët e Maqedonisë së Veriut të mërkurën i janë drejtuar kutive të votimit për t'i zgjedhur përfaqësuesit e tyre për përbërjen e re të Kuvendit. Këto janë zgjedhjet e dhjeta parlamentare dhe të parat në kushte të pandemisë me protokolle të veçanta shëndetësore për mbrojtje nga koronavirusi.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut ka njoftuar se në votimet për zgjedhjet parlamentare, deri në orën 17:00 kanë votuar 703 597 qytetarë apo 38.78 për qind nga trupi i përgjithshëm prej rreth 1.8 milion zgjedhës. Sipas KShZ-së, pjesëmarrja më të lartë ka në njësinë e tretë zgjedhore prej 43,87-përqindësh, ndërsa më e ulëta mbetet në njësinë e gjashtë zgjedhore prej 29-përqindësh. Në këtë njësi është numri më i

madh i votuesve shqiptarë. KShZ-ja ka njoftuar edhe për disa probleme në disa vendvotime lidhur me fletët e votimit, por kjo, sipas zëdhënësit Shabani, nuk ka ndikuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Në një vendvotim në Shkup një person është arrestuar nga policia për shkak të fotografimit të votës.

Kryetari i LSDM-së, Zoran Zaev, zgjedhjet e të mërkurës në Maqedoninë e Veriut i ka vlerësuar shumë të rëndësishme dhe të veçanta si për faktin se zhvillohen në kushte pandemie, por edhe për rezultatin që, siç ka thënë, do ta përcaktojnë rrugën nëpër të cilën do të lëvizë vendi në katër vjetët e ardhshëm.

Edhe kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, pas votimit në Zajas të Kërçovës, ka thënë se, para së gjithash, që procesi i votimit të



jetë i rregullt, duhen respektuar udhëzimet shëndetësore. "Hapet një faqe e re në historinë e këtij vendi, për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ku fituesit kanë një përgjegjësi historike për t'i përmbushur kushtet e nevojshme për BE. Do të duhet të punojmë për ngritjen e

standardit të jetesës, arsimit më të mirë dhe shëndet. Pra, do të ketë shumë punë për t'i përmbushur kërkesat dhe pritjet e njerëzve. Jam i bindur se ne do të kemi sukses në këtë. Platforma jonë është e njohur. Unë pres një fitore në kompleksin shqiptar", ka

deklaruar kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti.

Ndërkohë, Zijadin Sela, kryetar i Aleancës për Shqiptarët, që është në koalicion me partinë Alternativa, gjithashtu beson në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor dhe fitoren e opozitës shqiptare.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka takuar në Bruksel komisionarin e Bashkimit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi

Hoti në Bruksel: Liberalizimi i vizave, nevojë urgjente

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, gjatë takimit me komisionarin e Bashkimit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi, ka thënë se liberalizimi i vizave është nevojë urgjente për qytetarët e Kosovës. Hoti ka theksuar se është e rëndësishme që edhe Bashkimi Evropian t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm që të sigurohet lëvizja e lirë për qytetarët e Kosovës. Ndërsa Oliver Varhelyi e siguroi kryeministrin Hoti se Kosova si pjesë e kontinentit është dhe do të jetë pjesë e kësaj strategjie



pjesë e kësaj strategjie.

Hoti sot takohet me Vuçiqin

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, sot (e enjte) në Bruksel do të ketë takim të përbashkët me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Sipas njoftimeve nga BE-ja, takimi Hoti - Vuçiq do të nisë të enjten në orët e pasdites. Nga ana e BE-së takimin do ta lehtësojnë përfaqësuesi i lartë i

konferencë virtuale.

Në BE tashmë konsiderojnë se dialogu ka rifilluar. Zyrarët evropianë thonë se palët kanë rënë dakord për agjendën e dialogut, por nuk japin hollësi se cilat tema pritet të jenë në rend dite.

Nga burimet brenda BE-së është përmendur edhe mundësia që presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, të organizojë nesër një takim të përbashkët me kryeministrin Hoti dhe presidentin Vuçiq para se të nisë takimi në kuadër të dialogut. Në këtë mënyrë BE-ja dëshiron të tregojë se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë qëndron më së larti në agjendën e Bashkimit Evropian. Por, ky takim me presidentin e Këshillit Evropian varet edhe nga agjenda e tij, pasi ai është në konsultime të pandërprera me shefat e shteteve apo qeverive të BE-së në përpjekje për ta arritur marrëveshjen për kornizën shumëvjeçare financiare të BE-së dhe fondit për rimëkëmbje.

Këto do të jenë edhe temat kryesore të samitit të BE-së, të premtën dhe të shtunën në Bruksel, samiti i parë me praninë fizike të shefave të shteteve apo qeverive të BE-së që nga fillimi i pandemisë.

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

BRUKSEL, 15 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, brenda pak ditësh ka takuar për të dytën herë komisionarin e Bashkimit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike në vend si dhe për procesin e rimëkëmbjes ekonomike pas përballjes me pandeminë Covid 19, duke përfshirë këtu edhe bisedën për projektet e mëdha infrastrukturore të cilat janë pjesë e pakos së rimëkëmbjes. Temë kryesore e këtij takimi ishte procesi i liberalizimit të vizave. Kryeministri Hoti ka theksuar

nevojën urgjente për përmbylljen e këtij procesi si një ndër çështjet më me rëndësi të Kosovës në raport me Bashkimin Evropian. Ai ka thënë se Kosova dhe qytetarët e saj janë të përcaktuar në orientimin e tyre euroatlantik. Në këtë drejtim kryeministri Hoti ka vlerësuar se është e rëndësishme që edhe Bashkimi Evropian t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm që të sigurohet lëvizja e lirë për qytetarët e Kosovës. Në këtë takim u fol edhe për nevojën për strategji dhe protokolle të përbashkëta regjionale e evropiane për luftimin e pandemisë, ndërsa Varhelyi e siguroi kryeministrin Hoti se Kosova si pjesë e kontinentit është dhe do të jetë

Mavraj: Gjykata Speciale është projekt i thellë strategjik pro rus

PRISHTINË, 15 KORRIK - Profesori universitar, publicisti dhe botuesi Muhamet Mavraj, në emisionin "Imazh" të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), ka folur sot për intervistimin e presidentit Hashim Thaçi i cili që tri ditë është duke dhënë intervistë në Gjykatën Speciale në Hagë. Mavraj ka thënë se kjo propozimaktakuzë ndaj Thaçit dhe të tjerëve është e dobët. "Sot është dita e tretë e qëndrimit të Thaçit në Prokurorinë Speciale të Hagës. Dita e parë, sa di unë, ka kaluar pa pjesëmarrjen e Thaçit në debat. Vetëm debat juridik ndërmjet prokurores dhe këshilltarit ligjor të Thaçit, sepse ai nuk është i akredituar. Ato biseda nuk janë shteruar në ditën e parë dhe kanë vazhduar edhe në ditën e djeshme. Për sot nuk e di nëse po intervistohet Thaçi apo prokurorja dhe avokati po intervistojnë në lidhje me procedurat dhe këto shkeljet e qarta të ligjit që e kanë themeluar këtë Prokurorinë Speciale, Gjykatën Speciale, e ku pamë që Prokuroria Speciale i ka dhënë vetes kompetenca të cilat nuk ia kanë dhënë Kushtetuta dhe Kuvendi i Kosovës. Dhe ajo

kompetencë pretendon edhe diktimin e Kosovës se çfarë nuk duhet të diskutojë në Shtëpinë e Bardhë ose diku tjetër në lidhje me debatet politike Kosovë - Serbi e që nuk është puna e saj fare", ka thënë Mavraj. Duke folur për themelimin e Speciales, për rrjedhat se si ka ardhur kjo gjykatë, Mavraj ka thënë se të gjitha procedurat për themelimin e saj kanë qenë tërësisht politike. "Nuk e kanë natyrën e ndjekjeve të fajeve të luftës, por kanë qëllime të tjera larghedhëse. Këto po vazhdojnë qyshkur është shpallur pavarësia e Kosovës, por në dhjetëvjetëshin e fundit kanë qenë më intensive dhe kanë prodhuar efekte pa filluar fare puna e gjykatës, me debate, akuza publike dhe shpifje", ka thënë Mavraj. Ai ka shtuar se këto akuza dhe shpifje synim kanë pasur që Kosovën ta paraqesin si agresore dhe Serbinë si viktimë. Mavraj ka bërë me dije se Gjykata Speciale është projekt i thellë strategjik pro rus. Ai ka thënë se kjo gjykatë ishte kompromis i dhimbshëm për Kosovën. "Rasti i Speciales, sa për BE-në, nuk do të ishte ngritur



kurrë, por ShBA-ja mori pozicion të atillë që Kosova ishte me këmbë në qafë dhe ishte e detyrueshme, në njëfarë mënyrë, që vetë Thaçi u dashtë t'i motivojë deputetët që të votohet, duke e ditur se vetë është shënjestra kryesore dhe duke e ditur se ky do të jetë i ftuari i parë", është shprehur Mavraj. Ai ka thënë se në raportin e Dick Martyt shënjestra kryesore e Serbisë ka qenë Hashim Thaçi dhe çdo anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. "Kjo është koka, e pastaj

zbrasin në nivel të dytë në komandantët e zonave", ka deklaruar Mavraj. Duke folur rreth deklaratave të fundit të presidentit serb në raport me zhvillimet në Kosovë, Mavraj ka thënë se Vuçiqi ka qenë ministër i Millosheviqit. "Është personi që i urdhëron përfaqësuesit e serbëve të Kosovës në Kuvendin e Kosovës që të dalin jashtë kur përmendet gjenocidi i serbëve të Bosnjës. Prirja e tij është për t'u paraqitur viktimë. Mbi këtë boshtin e viktimizimit kanë ardhur deri te

kjo Gjykata Speciale", ka thënë Mavraj, i cili e ka komentuar edhe rezolutën e cila këto ditë ka kaluar në Kuvend, e që ka të bëjë me mbrojtjen e vlerave të luftës. "Rezoluta e Kuvendit të Kosovës ka të bëjë, thjesht, me mbrojtjen e vetes, sepse Kuvendi i Kosovës kurrë nuk do të ishte ngritur dhe nuk do të funksiononte pa ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Madje as përfaqësuesit e serbëve të Kosovës nuk do të ishin aty pa luftën e UÇK-së dhe pa intervenimin ndërkombëtar që ka ndodhur këtu", ka thënë Mavraj.

FLET PËR “EPOKËN E RE”, TIME KADRIJAJ

BE-ja PO TREGOHET E PA



Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Time Kadrijaj, ka bërë me dije se BE-ja po tregohet e padrejtë me Kosovën. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ajo ka thënë se derisa vende të tjera të rajonit kanë avancuar në procesin e integritimit evropian, Kosovës ende nuk i është dhënë liberalizimi i vizave. Për këtë arsye, ajo ka thënë se u ka shkruar letër komisioneve të punëve të jashtme të parlamenteve të vendeve të BE-së, të Mbretërisë së Bashkuar dhe të ShBA-së. Kadrijaj ka thënë se mosliberalizimi i vizave po e ul besueshmërinë e BE-së te qytetarët e Kosovës

Kadrijaj ka deklaruar se edhe institucionet e tjera të Kosovës duhet të llojnë te vendet anëtare të BE-së në mënyrë që të rritet presioni për vendimmarrje për këtë proces. “Ne si institucion e kemi të drejtën e lobimit përmes diplomacisë parlamentare te vendet anëtare të BE-së për çështjen e liberalizimit të vizave. Këtë gjë duhet ta bëjnë edhe institucionet e tjera sepse politika e jashtme e Kosovës duhet ta ketë një zë në mënyrë që të përmbillet edhe kjo çështje. Sa më shumë që të bëjmë trysni dhe sa më shumë që të bëjmë kërkesa te vendet anëtare të BE-së, ato vende do të sensibilizohen për këtë çështje dhe besoj se do të marrin përkrahje”, është shprehur deputetja e AAK-së.

“Epoka e re”: Zonja Kadrijaj, si kryetare e Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë, u keni shkruar kryetarëve të komisioneve të punëve të jashtme të parlamenteve të vendeve të BE-së, të Mbretërisë së Bashkuar dhe të ShBA-së në lidhje me

liberalizimin e vizave për Kosovën. Pse e ndërmoret këtë iniciativë?

Kadrijaj: Ne si komision e kemi edhe obligim ligjor që, duke përdorur diplomacinë parlamentare, të llojmë për çështje të ndryshme. Kjo iniciativë është përkrahur edhe nga anëtarët e tjerë të komisionit, që t’u shkruajmë komisioneve si motra, pra komisioneve të punëve të jashtme të parlamenteve të vendeve të BE-së, të Mbretërisë së Bashkuar dhe të ShBA-së, nga të cilët kemi kërkuar që të na ofrojnë përkrahje në këtë proces dhe të ndikojnë në vendet e tyre në mënyrë që edhe Kosova të ketë liberalizim të vizave. Këtë iniciativë e kemi arsyetuar me atë se Kosova ka përbushur kriteret e nevojshme për liberalizim të vizave, Komisioni Evropian ka dhënë rekomandim pozitiv për liberalizim të vizave dhe është votuar në Parlamentin Evropian. Dihet se tani çdo shtet do të ketë fjalën e vet në këtë proces dhe ne si komision kemi kërkuar nga kryetarët e komisioneve për punë të jashtme të parlamenteve

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 15 KORRIK - Kryetarja e Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Time Kadrijaj, ka marrë iniciativë që t’u drejtohet kryetarëve të komisioneve të punëve të jashtme të parlamenteve të vendeve të BE-së, Mbretërisë së Bashkuar dhe ShBA-së, për ta shprehur shqetësimin për pamundësinë e qytetarëve të Kosovës që të udhëtojnë pa viza. Ajo ka thënë se këtyre komisioneve edhe një herë ua ka rikujtuar që Kosova i ka përbushur të gjitha kriteret për liberalizim të vizave.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Kadrijaj ka deklaruar se komisionet parlamentare si motra duhet të bëjnë presion te vendet anëtare të BE-së për liberalizim të vizave. “Këtë iniciativë e kemi arsyetuar me atë se Kosova ka përbushur kriteret e nevojshme për liberalizim të vizave, Komisioni Evropian ka dhënë rekomandim pozitiv për liberalizim të vizave dhe kjo është votuar në Parlamentin Evropian. Dihet që tani se çdo shtet do ta ketë fjalën e vet në këtë proces dhe ne si komision kemi kërkuar nga kryetarët e komisioneve për punë të jashtme të parlamenteve përkatëse që të ndikojnë në

vendet e tyre në mënyrë që të kemi liberalizim të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës”, ka thënë Kadrijaj. Ajo ka bërë me dije se BE-ja po tregohet e padrejtë me Kosovën. Sipas saj, këto veprime po e ulin besueshmërinë e BE-së te qytetarët e Kosovës. “Serbia që sa vite i ka hapur negociatat për anëtarësim, ndërsa Kosova ende nuk e ka marrë liberalizimin e vizave, atëherë këtu nuk kemi drejtësi evropiane. Këto veprime të BE-së në të njëjtën kohë po ndikojnë në uljen e besueshmërisë së popullit dhe institucioneve të Kosovës në institucionet e BE-së”, është shprehur ajo.

DREJTË ME KOSOVËN



përkatëse, që të ndikojnë në vendet e tyre në mënyrë që të kemi liberalizim të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

“Epoka e re”: Sa besoni se kjo kërkesë e juaja do të gjejë mbështetje?

Kadrijaj: Ne si deputetë dhe si komision duhet ta bëjmë punën tonë, duke iu adresuar në mënyrë të vazhdueshme vendeve të BE-së, se Kosovës po i bëhet padrejtësi në këtë proces. Sepse Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet që i janë kërkuar për procesin e liberalizimit të vizave. Tani është radha e BE-së që të marrë vendim për këtë çështje. Kosova është vendi më proevropian në rajon dhe është e pakuptimtë që ne ende të mbesim si vendi më i izoluar në Evropë. Dihet se Kosova është vendi që ka përmbushur kriteret për këtë proces më mirë se vende tjera. Sa i përket kriterit të luftimit të krimit dhe korrupsionit, ai është kriter që duhet të punohet në vazhdimësi për plotësimin e tij. Pra, në këtë mënyrë kemi dashur t'i sensibilizojmë këto komisione në këtë drejtim.

“Epoka e re”: Sa jeni optimiste se gjatë presidencës gjermane të BE-së çështja e liberalizimit të

vizave do të futet në agjendë?

Kadrijaj: Gjermania është një vend i BE-së që e ka përkrahur Kosovën në të gjitha etapat e zhvillimit të saj, prej para luftës, gjatë luftës dhe tani gjatë procesi të ndërtimit të shtetit. Duke llogaritur se Gjermania është një vend mik i Kosovës, jam optimiste se gjatë presidencës së saj do të bëhet diçka në këtë drejtim.

“Epoka e re”: Institucionet e tjera të Kosovës, çfarë duhet të bëjnë gjatë kësaj kohe për t'i sensibilizuar vende anëtare të BE-së për këtë proces?

Kadrijaj: Secili institucion i ka detyrat dhe obligimet e veta karshi vendit dhe këtij procesi. Në këtë mënyrë secili institucion duhet t'i kryejë obligimet e veta që i ka të përcaktuara me ligj. Në këtë drejtim ne si institucion e kemi të drejtën e lobimit përmes diplomacisë parlamentare te vendet anëtare të BE-së për çështjen e liberalizimit të vizave. Këtë gjë duhet ta bëjnë edhe institucionet e tjera sepse politika e jashtme e Kosovës duhet ta ketë një zë në mënyrë që të përmbillet edhe kjo çështje. Sa më shumë që të bëjmë trysni dhe sa më shumë që të bëjmë kërkesa te vendet anëtare të BE-së, ato vende do të sensibilizohen për këtë çështje dhe besoj se do të

marrin përkrahje.

“Epoka e re”: Kohët e fundit edhe i dërguari special i ShBA-së për dialogun Kosovës - Serbi, z. Grenell, ka kërkuar nga BE-ja që t'i liberalizojë vizat për qytetarët e Kosovës. A mund të ketë ndonjë ndikim në procesin e liberalizimit të vizave ky presion?

Kadrijaj: ShBA-ja është partnerja strategjike e Kosovës. Përfshirja e ShBA-së në këtë proces është shumë pozitive. Ne e mirëpresim këtë përfushje të ShBA-së, por dihet se qëllimi i Ballkanit Perëndimor është që të integrohet në BE. Ne do të kërkojmë që integrimi i këtyre vende në BE të bëhet njëkohësisht dhe jo që dikush të integrohet më herët e dikush më vonë. Sepse Kosova çdoherë u është përgjigjur pozitivisht kërkesave të BE-së. E përmenda më herët se i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizim të vizave dhe prapë Kosova po stagnon në të gjitha këto procese. Pra, Serbia që sa vite i ka hapur negociatat për anëtarësim, ndërsa Kosova ende nuk e ka marrë liberalizimin e vizave, atëherë këtu nuk kemi drejtësi evropiane. Këto veprime të BE-së në të njëjtën kohë po ndikojnë në uljen e besueshmërisë së popullit dhe institucioneve të Kosovës në institucionet e BE-së.

Qeveria mbështet ndërtimin e Kompleksit Universitar të Gjakovës “Fehmi Agani”

GJAKOVË, 15 KORRIK (ER) - Rektori i Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”, prof. ass. dr. Artan Nimani, ka zhvilluar një takim me Besnik Tahirin, zëvendëskryeministrin e parë të Republikës së Kosovës, nga i cili ka marrë mbështetjen e plotë për ndërtimin e Kompleksit Universitar të UGJFA-së.

Rektori Nimani ka shprehur falënderim për gatishmërinë, përkrahjen dhe vizitën e zëvendëskryeministrit të parë të Republikës së Kosovës, Besnik Tahiri, me bashkëpunëtorë, në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”.

Gjatë takimit, rektori Nimani e ka informuar Tahirin për të arriturat e UGJFA-së, për ngritjen e UGJFA-së për 3 446 pozita më lart në radhitjen botërore të universiteteve në WEBOMETRICS, për ndërkombëtarizimin dhe për bashkëpunimet e uni-

versitetit me institucione dhe organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare, për fondet e fituara nga Erasmus+, që kapin vlerën e mbi 2 milionë eurove, si dhe për përgatitjet e nisjes së Kompleksit Universitar të UGJFA-së, për të cilin janë në përfundim të disa procedurave dhe parashihet që punimet të nisnin në muajin tetor.

Zëvendëskryeministri Tahiri në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës u zotua se me gjithë kapacitetet që ofron do ta mbështet ndërtimin e Kompleksit Universitar të UGJFA-së.

Po ashtu, Tahiri u ndie i kënaqur me pritjen që iu bë nga rektori Nimani me bashkëpunëtorë në Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”.

Sipas planit ideor, është një kompleks modern, i cili do t'i



përmbushë të gjitha normativat evropiane që kërkohen dhe, si i tillë, i është përshtatur

ekstraktit të planifikimit urban të qytetit dhe do të ofrojë zgjidhje afatgjatë në mundësinë e

studimeve për studentët e Gjakovës me rrethinë dhe ata të rajonit.

Më 23 korrik mblidhet Kuvendi, në shqyrtim edhe projektligji në lexim të dytë për buxhetin

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 KORRIK- Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nën drejtimin e kryetares Vjosa Osmani, ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës në mënyrë elektronike (virtuale), në të cilën vendosi që Kuvendi të mblidhet në seancë plenare më 23 korrik. “Në orën 10:30, Kuvendi do të vazhdojë seancat me pikat e mbetura nga seancat e kaluara, përkatësisht votimin e pesë marrëveshjeve ndërkombëtare, për të cilat nevojiten 80 vota për, si dhe dy propozim-rezolutat nga debati i fundit i Kuvendit lidhur me menaxhimin e pandemisë Covid-19 nga ana e qeverisë. Ndërkaq në orën 11:00, do të fillojë seanca e rregullt plenare, me pikat e rëndomtë të rendit të ditës: deklarime jashtë rendit të ditës dhe pyetje parlamentare. Seanca pritet të vazhdojë me

debatin parlamentar lidhur me situatën financiare në Telekomin e Kosovës, të kërkuar nga GP i Vetëvendosjes, si dhe debatin parlamentar sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur edhe nga shtatë deputetë nënshkrues, për të drejtat e pensionistëve kontributdhënës”, është bërë me dije në njoftimin e Kuvendit të Kosovës.

Sipas këtij njoftimi, nëse Komisioni për Buxhet dhe Transfere arrin ta kryejë punën e tij, pikë e fundit e rendit të ditës së kësaj seance pritet të jetë shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Në këtë mbledhje, Kryesia ka shqyrtuar edhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e saj. “Kështu, komisionet përkatëse u ngarkuan me shqyrtimin e tri projektligjeve: Projektligjit për



masat e përkohshme për ta lehtësuar efektin e pandemisë Covid-19, Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, me Ligjin nr.

04/L-116, me Ligjin 04/L-194, me Ligjin 05/L-063, dhe me Ligjin 05/L-007, si dhe Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, për të cilat qeveria ka dhënë opinion negativ, duke i konsideruar të

panevojshme. Po ashtu për shqyrtim në komisionin përkatës parlamentar u procedua edhe Projektligji për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i mbështetur edhe nga qeveria”, është bërë me dije në njoftimin e Kuvendit.

UNICEF-i i jep donacion IKShPK-së pajisje për testimin e cilësisë së ujit të pijshëm

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 KORRIK - Zyra e UNICEF-it në Kosovë ia ka dorëzuar të mërkurën Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhjetë sete të pakove për testimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Këto pajisje ishin përdorur nga Agjencia e Statistikave e Kosovës gjatë punës në terren me Anketën e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë (MICS).

Anketa MICS ofron të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme në nivel ndërkombëtar për shëndetin dhe ushqyerjen e fëmijëve, vdekshmërinë, mbrojtjen, edukimin dhe kushtet e përgjithshme të jetesës si dhe



informata në lidhje me shëndetin riprodhues dhe kushtet e jetesës së grave dhe burrave.

Që nga dhjetori i vitit 2019 deri në mes të marsit të vitit 2020 nëntë ekipe të MICS-it kanë mbledhur të dhëna duke

përdorur tableta, gjë që siguron cilësinë dhe besueshmërinë e informatave të mbledhura në terren.

Ekipet kanë vizituar të gjitha zonat e përzgjedhura të numërimit dhe i intervistuar rreth 8 000 familje, mblodhën mostrat e ujit nga popullsia e përgjithshme dhe komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

Anketa MICS 2019-2020 në Kosovë, e cila është planifikuar të kryhet në tremujorin e fundit të vitit 2020, do të ofrojë të dhëna të besueshme, të përpikta dhe të krahasueshme në nivel ndërkombëtar në lidhje me rreth 200 treguese - gjysma e të gjithë treguesve OZhQ të Anketës - që lidhen me edukimin shëndetësor, mbrojtjen, kushtet e përgjithshme të jetesës dhe

shëndetin riprodhues të grave dhe burrave. Të dhënat janë tërësisht të ndara sipas gjinisë, grupmoshave, zonës së vendbanimit, kuintileve të pasurisë, aftësisë së kufizuar dhe statusit të migrimit, përkatësisë etnike e kështu me radhë.

MICS-i do ta tregojë progresin e arritur që nga MICS-i i mëparshëm i kryer në periudhën 2013-2014 dhe do të mundësojë analiza të të dhënave të mëtejshme për të ofruar fakte për fëmijët në familjet e tyre, para, gjatë dhe pas pandemisë Covid-19. UNICEF-i mbetet i përkushtuar ta vazhdojë partneritetin e vet me të gjithë aktorët për të avokuar për ndërhyrje të mëtejshme bazuar në gjetjet e MICS 2019-2020 në Kosovë.

Policia zbulon mbi 20 kilogramë substancë narkotike të llojit marijuanë

PRISHTINË, 15 KORRIK (ER) - Policia e Kosovës ka arrestuar pesë persona të dyshuar që ndërlidhen me rastin e veprave penale “Blerja, posedimi, shitja ose shpërndarja e paautorizuar e substancave narkotike (Neni 267) dhe Mbajtja në pronësi apo kontroll e paautorizuar e armëve (Neni - 366)”.

Përmes një njoftimi për media, policia ka treguar se pas pranimit të informatave në lidhje me rastet e lartcekura, ka zhvilluar një hetim intensiv dymujor, me ç'rast më 14.07.2020 në Prishtinë ka

realizuar një operacion policor gjatë të cilit njësi e Drejtorisë e Hetimit e Trafikimit të Narkotikëve ka ndaluar tri vetura të dyshuara në të cilat janë hasur pesë persona të dyshuar. “Gjatë realizimit të kontrollimit të personave dhe veturave të dyshuara, në një nga veturat e ndaluar është gjetur një sasi e narkotikëve e llojit ‘marijuanë’ me peshë të përgjithshme prej 13 kg e 800 gramësh, së bashku me mbështjellës. Në lidhje me rastin, pas konsultimit me prokurorin kompetent, me

urdhër të tij është realizuar edhe një kontroll i lokacioneve të cilat dyshohet se janë shfrytëzuar për fshehje të substancave narkotike. Gjatë realizimit të këtij kontrolli te të dyshuarit janë gjetur: 5 paketime me substancë narkotike të llojit marijuanë me peshë të përgjithshme prej 6 kg e 206 gramësh, 3 peshore elektronike, qese për paketim të substancës narkotike, folje alumini, një palë doreza, një armë zjarri, një karikator, tre fishekë, 11 paktime dhe një cigare e mbushur me substancë e llo-



jit marijuanë me peshë 25.1 gramë dhe 7 540 euro”, është thënë në njoftimin e policisë. Të dyshuarit janë intervistuar

në prani të mbrojtësve të tyre dhe me vendim të prokurorit të njëjtët janë dërguar në qendër të mbajtjes.

Covid-19 në Kosovë: 5 237 raste pozitive, 2 462 të shëruar, 112 të vdekur dhe 2 663 raste aktive

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit janë paraqitur 119 raste të reja me Covid-19 si dhe janë shëruar 32 persona të prekur nga koronavirusi. Sipas këtij Instituti, nga 119 rastet e reja me Covid-19, vetëm në Prishtinë janë paraqitur 63. Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, në një konferencë për medie ka thënë se do t'i rrisin kapacitetet për testime me Covid-19. Kujtojmë se në Kosovë nga marsi janë paraqitur 5 237 raste me Covid-19, prej tyre 2 462 persona janë shëruar dhe 112 kanë ndërruar jetë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 KORRIK - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar për 119 raste pozitive dhe 92 të shëruar me Covid-19 në 24 orët e fundit. Ndërsa sa i përket bilancit të përgjithshëm me Covid-19, IKShPK-ja ka njoftuar për 5 237 raste pozitive, 2 462 të shëruar, 112 të vdekur dhe 2 663 raste aktive. "Më datën 14 korrik 2020 në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 420 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 119 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 5 237 raste nga 29 060 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 112 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Më datë 14 korrik 2020 janë shëruar 92 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 2 462 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 663", ka njoftuar IKShPK-ja. Nga 119 rastet e reja me Covid-19, sipas IKShPK-së, Prishtina renditet e para me 63 raste, e pasuar nga Gjakova dhe Drenasi. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 63 raste, komuna Gjakovë 12 raste,

komuna Drenas 6 raste, komuna Fushë-Kosovë 5 raste, komuna Pejë 5 raste, komuna Podujevë 5 raste, komuna Skenderaj 3 raste, komuna Ferizaj 2 raste, komuna Deçan 2 raste, komuna Gjilan 2 raste, komuna Istog 2 raste, komuna Kaçanik 2 raste, komuna Lipjan 2 raste, komuna Vushtrri 2 raste, komuna Obiliq 2 raste dhe me nga 1 rast komunat: Kamenicë, Klokot, Mitrovicë dhe Rahovec", ka njoftuar IKShPK-ja. Më tutje, IKShPK-ja ka ftuar qytetarët që t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore për mbrojtje nga Covid-19. "Virusi është kudo! Ju lutemi përmbahuni rekomandimeve! Virusit vret! Zbatimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta bëjë çdo qytetar i Republikës së Kosovës, që ta ruajë veten, të afërmit dhe të tjerët. Bartja e maskave mbetet obligative! Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura. Ne po shkojmë drejt një normaliteti të ri. Ky normaliteti i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të mirë, për ta mbajtur higjienën, për ta mbajtur

distancën, për ta mbajtur maskën, për t'i mos përhapur piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmit, të familjes, të fëmijëve, të farefisit, të komunitetit, pastaj të gjithë qytetarëve", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se çdo shkelje e rekomandimeve të institucioneve shëndetësore nënkupton rrezikim i shëndetit. "Inspektoratet sanitare të AUV dhe inspektoratet komunale bashkë me shtabet komunale duhet patjetër ta zbatojnë Ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse duke u mbështetur në Manualin për luftimin e Covid-19 dhe të merren masa përgjegjësie në çdo rast të mos zbatimit eventual të rekomandimeve të Institutit Kombëtar. Çdo shkelje e rregullave nga kushdo të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve. Nuk ka të drejtë askush të rrezikojë jetën e të afërmit të tyre, të moshuarve dhe personave me sëmundje kronike për shkak të pakujdesit dhe moszbatimit të rekomandimeve. Vazhdoni ta mbani distancën fizike dhe maskat! Lani duart me kujdes disa herë në ditë nga 20-30

sekonda. Lehtësimi i masave është bërë për të na bërë më të përgjegjshëm! Ju lutem të keni kujdes, sepse akoma ekziston rreziku i përhapjes në vendet ku ka grumbullim të madh të njerëzve!", ka njoftuar IKShPK-ja.

Ministri Zemaj: Do t'i rrisim kapacitetet për testime me Covid-19

Statistikat me Covid-19 janë prezantuar të mërkurën në një konferencë për media edhe nga ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, drejtori i IKShPK-së, Naser Ramadani, dhe ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi. Në këtë konferencë, ministri Zemaj ka bërë me dije se tash e tutje informatat në lidhje me Covid-19 do të bëhen publike çdo ditë në orën 15:00. Në këtë kontekst, Zemaj ka thënë se do t'i rrisin kapacitetet për testime për Covid-19, duke përfshirë klinikat shtetërore dhe private. "Do t'i zgjerojmë kapacitetet tona edhe për klinikat private, por edhe të atyre publike. Sigurisht se do t'i rrisim kapacitetet e testimeve ashtu

siç kanë rekomanduar ekspertët e IKShPK-së dhe të OBSH-së", ka thënë Zemaj, duke falënderuar mediat për raportimet e tyre korrekte në lidhje me situatën pandemike. Ndërsa ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm i ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, ka dhënë detaje lidhur me numrin e pacientëve që kanë rezultuar pozitivë me Covid-19, të cilët janë duke u trajtuar në klinikat e QKUK-së dhe në spitalet regjionale. Krasniqi ka thënë se në klinikat e QKUK-së aktualisht janë duke u trajtuar 494 pacientë të konfirmuar dhe të dyshuar për Covid-19, duke shtuar se 13 prej tyre janë në gjendje kritike. "Sot nëpër klinikat Covid të QKUK-së dhe në spitalet rajonale të Kosovës janë duke u trajtuar 494 raste të dyshuar për Covid-19. 314 raste janë të konfirmuar me Covid-19. Nga 314 raste, 177 pacientë po trajtohen në klinikat e Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës dhe 137 të tjerë në spitalet regjionale. Nga numri total kemi 13 pacientë në ventilim mekanik ose si të intubuar apo i vlerësojmë në gjendje kritike, dhe kemi 23 pacientë të tjerë i kemi me metodë joinvazive të ventilimit apo të njohur si 'cipar'", ka thënë Krasniqi.

Abrashi: Së shpejti nisim procedurat për ndërtimin e tranistit të Klinës



KLINË, 15 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, bashkë me kryetarin e Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, kryesuesin e Kuvendit Komunal, Fadil Gashi dhe nënkryetarin e Besim Hoti, janë marrë vesh për vazhdimin e projekteve të parapara në këtë komunë. Ministri Abrashi është zotuar se së shpejti do të shpallen procedurat për nisjen e ndër-

timit të transitit të Klinës. "Me kryetarin e Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, u pajtuam që së shpejti Ministria e Infrastrukturës do t'i nisë procedurat për ndërtimin e rrugës së transitit të Klinës. Kjo rrugë do të shërbejë për shkarkimin e qytetit të Klinës nga numri i madh i veturave dhe lidhjen më të mirë me qytetet përreth", ka thënë ministri Abrashi.

Ndërsa kryetari i Klinës e ka falënderuar ministrin për mbështetjen dhe vazhdimin e projekteve në këtë komunë, duke e vlerësuar shumë të rëndësishëm ndërtimin e transitit të Klinës. Kryetari Elezaj ka thënë se rruga transitorë që parashihet do ta shkarkonte qytetin e Klinës nga komunikacioni i dendur i të gjitha llojeve të automjeteve.

Blllokohen llogaritë e Telekomit,

Sindikata e Pavarur e PTK-së ka njoftuar se Telekomit të Kosovës i janë bllokuar llogaritë bankare nga përmbauesi privat për rastin me “Z-Mobile”. Kjo sindikatë ka paralajmëruar protesta nëse nuk zgjidhet ky rast. Po ashtu, reagime ka pasur edhe nga menaxhmenti i Telekomit si dhe nga Lëvizja Vetëvendosje



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 KORRIK - Sindikata e Pavarur e PTK-së ka njoftuar se Telekomit të Kosovës i janë bllokuar llogaritë bankare nga përmbauesi privat për rastin me “Z-Mobile”. Kjo sindikatë e ka quajtur të papranueshëm këtë veprim dhe ka kërkuar ndërhyrjen e institucioneve. Ditë më parë Gjykata Themelore në Prishtinë vendosi për përmbauesin/realizimin të borxhit mbi 24 milionë eurosh ndaj kompanisë “Dardafon.net”, e cila kishte fituar rastin në Arbitrazh. E lidhur me këtë rast kan reagu edhe ministri i linjës, Blerim Kuçi, menaxhmenti i Telekomit, Sindikata e Pavarur ka paralajmëruar protestë, kurse ka reagu edhe Lëvizja Vetëvendosje.

Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, është deklaruar rreth situatës së krijuar në Telekomin e Kosovës.

Kuçi ka thënë se gjatë ditës së sotme në lidhje me bllokimin e llogarive bankare të Telekomit të Kosovës po punohet dhe do të gjendet zgjidhja më e mirë e mundshme. “Gjatë ditës së sotme keni mundur të lexoni në media rreth bllokimit të llogarive bankare të Telekomit të Kosovës. Ky bllokim natyrisht se na ka shqetësuar

dhe i gjithë kabineti im po merret intensivisht me institucionet relevante për të gjetur zgjidhje. Filli i kësaj situatë që po ndodhë sot është në vitin 2016, kur operatori ekonomik ‘Dardafon.net’ ka fituar në Tribunalin Ndërkombëtar të Arbitrazhit, aty ku i është njohur e drejta për përmbauesin të borxhit”, thuhet në deklaratën e Kuçi.

Ai i ka ftuar aktorët e Telekomit që të jenë racionalë në deklaratë dhe veprime. “Tashmë kemi një vendim të Gjykatës Themelore të Prishtinës që urdhëron përmbauesin, mirëpo jam i bindur se do të arrijmë më të mirën e mundshme. Ne kemi azhurnuar takimet dhe besojmë në zgjidhje. Ftoj punëtorët e Telekomit dhe aktorët e tjerë të jenë racionalë në deklaratë dhe veprime”.

Telekomi i Kosovës me shqetësim të jashtëzakonshëm ka pranuar informatën se janë bllokuar llogaritë bankare të korporatës sipas aktvendimit PPP nr. 1486/19 të datës 06.07.2020, për të siguruar kështu përmbauesin e borxhit ndaj “Z-Mobile”. Menaxhmenti i Telekomit të Kosovës, porsa është njoftuar me aktvendimin e gjykatës Themelore në Prishtinë, për refuzimin e prapësimit të përmbauesit, ka njoftuar aksionarin dhe të gjitha institucionet relevante, duke ua bërë me dije pasojat e

pariparueshme të bllokimit eventual të llogarive bankare. “Gjithashtu, prej tyre kemi kërkuar me këmbëngulje bashkërenditjen e veprimeve për t'i parandaluar dhe menaxhuar pasojat e rënda që sjell ky vendim. Me këtë rast e njoftojmë gjithë opinionin publik, institucionet e Republikës së Kosovës, se bllokimi i llogarive bankare të Telekomit të Kosovës tashmë ka shkaktuar një dëm të pariparueshëm, duke e rrezikuar kështu ofrimin e shërbimeve të pandërprera të komunikimeve elektronike, përfshirë këtu edhe ofrimin e

shërbimeve për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës (shërbimet e numrave emergjentë, policisë, zjarrfikësve, AKI-së, Qeverisë, Ministrive dhe Komunave, Ushtrisë së Kosovës, Entit Epidemiologjik, Spitaleve, IKShP-së) etj., të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve dhe të mbi një milion konsumatorëve të cilët përdorin shërbimet e Telekomit të Kosovës”, thuhet në komunikatën e Telekomit. Sipas kësaj komunikate, edhe në këto çaste menaxhmenti i Telekomit të Kosovës është duke e hartuar planin e

veprimin emergjent bazuar në këtë situatë dhe rrethanë të re, në mënyrë që të mund të mbajmë operimin dhe funksionalitetin e ofrimit të shërbimeve ndaj institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. “Gjendja është alarmante dhe kërkon mobilizimin urgjent të të gjitha institucioneve përgjegjëse shtetërore për tejkalimin e këtij rreziku që mund të shkatërrojë tërësisht këtë aset vital të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim është të zhblllokohen llogaritë bankare të Telekomit të

Në kohë të pandemisë, biznesi vendor ua paguan pagën e 13 punëtorëve

PRISHTINË, 15 KORRIK - Edhe pse në kohë pandemie Covid-19, ku shumë biznese vendore e kanë të vështirë që t'i paguajnë punëtorët, pronari i kompanisë “Meka”, Burim Piraj, ka bërë me dije se ka bërë ekzekutimin e pagës së 13-të për punëtorët e tij. Me këtë rast, Piraj në profilin e vet në “Facebook” ka shkruar se shpreson se do ta realizojë edhe një premtim tjetër, atë të pagës së 14-të.

“Elhamdulillah vetëm di të them. Dhe vetëm të madhit Allah i falënderohem për çdo të


mirë dhe çdo sprovë që ma ka dhuruar! Ai sot ma mundësoi ekzekutimin e pagës së 13-të dhe shpresoj të realizohet dhe e 14-ta sipas planit. I lutem të Madhit Allah që sprova me virusin të kalojë sa më parë, të sëmurët të shërohen dhe atyre që gjatë kësaj kohe i kanë humbur të dashurit e tyre zemra t'u zbutet dhe të marrin forcë për ta vazhduar jetën më tutje! Ja Allah, bekoje çdo mysliman kudo në botë, në veçanti bekoje popullin shqiptar. Na beko parinë dhe udhëzoje në rrugë të

drejtë ku do të fitojnë dhe sevapet e Tua për qeverisje të mirë”, ka shkruar Piraj.

Po ashtu, Piraj kishte vendosur t'ua paguajë vetë punëtorëve kompensimin e planifikuar nga Qeveria e Kosovës nga Pakoja Emergjente Fiskale. E njëjta kompani, pas deklaratës së ish-kryeministrit Albin Kurti se është absurde që paga mesatare në sektorin publik të jetë mbi 500 euro, ndërsa në atë privat të ngelet në 350 euro, kishte marrë vendim që kjo pagë të rritet në këtë vlerë.



kërkohet ndihmë institucionale



Blokoheh llogaritë bankare të Telekomit, Sindikata e Punëtorëve paralajmëron protesta

Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së ka mbajtur një konferencë për media pasi Telekomit të Kosovës i janë bllokuar llogaritë bankare nga përmbaruesi privat për rastin me "Z-Mobile". Me këtë rast, Lamih Balaj, kryetar i Federatës Sindikale të Pavarur të PTK-së, e ka quajtur të papranueshëm këtë veprim dhe ka kërkuar ndërhyrjen e

institucioneve. "Ky bllokim s'është bllokim, por edhe shkatërrim i Telekomit dhe nuk do të lejojmë një gjë të tillë. Ne kërkojmë nga përmbaruesi që sa më parë t'i zhbllokojë llogaritë që po dëshiron t'i shkatërronë mijëra familje", ka thënë Balaj, i cili ka bërë thirrje: "U bëjmë thirrje liderëve institucionalë që të largohet kompania kriminale

'Z-Mobile' dhe sa më parë të marrin masa adekuate që të zhbllokohen llogaritë. Blerimi po dëshiron që t'i lë 3 500 familje pa punë të cilat janë të futura në kredi. Edhe një herë u bëjmë thirrje institucioneve që të marrin masa në mënyrë që të zhbllokohen llogaritë", është shprehur Balaj. "Ne kërkojmë nga përmbaruesi, edhe nga ai që e ka dërguar

lëndën, që t'i zhbllokojë llogaritë sepse në këtë kohë pandemie po dëshiron t'i shkatërronë 3 500 familje të cilat janë të varura nga pagat e Telekomit të Kosovës. Për 10 vjet e kanë zhvatur këtë Telekom dhe sot po tentojnë që ta falimentojnë kompaninë tonë. Një gjë të tillë nuk do ta lejojmë", ka shprehur qëndrimin Balaj.



Kosovës dhe të suspendohet kjo masë", thuhet tutje në komunikatë.

Po ashtu, Lëvizja Vetëvendosje ka reaguar për bllokimin e llogarive të Telekomit të Kosovës nga përmbaruesi privat në lidhje me rastin e "Dardafone.net". "Sot morëm njoftimin se llogaritë e Telekomit të Kosovës janë bllokuar ashtu që 'Dardafone.net/Devolli' të zhvatë një borxh fiktiv të sajuar nëpër procese të orkestruara. Pra, 24.6 milionë euro i pretendon pala që sot duhet të ishte e paditur dhe e gjykuar bashkë me nënshkruarit menaxherialë

e politikë për kontratë me elementë të kriminit të organizuar. Çdo veprim që po bëhet mbi Telekomin është i orkestruar dhe i toleruar në bashkëpunim me drejtuesit politikë që gjenden në Qeverinë e Kosovës dhe partnerët e tyre politikë të klubit PLAN me të cilët po i kryejnë pazaret e të gjitha

niveleve. Për t'u theksuar është zelli i gjyqtarës në Gjykatën Themelore, që mes mijëra lëndëve që presin me vite, në kohë rekorde, në më pak se 2 javë ka nxjerrë një vendim me peshën e rrënimin të Telekomit e në favor të 'Dardafone.net' e Devollëve. Edhe një herë theksojmë se Telekomit i Kosovës është çështje e sigurisë

shtetërore, e sigurisë së 2 350 punëtorëve të Republikës së Kosovës dhe e gjithë sektorit të komunikimeve elektronike e shumë ndërmarrjeve të tjera publike e private të lidhura me Telekomin. Kjo duhet të ndalet sa më parë dhe heshtja e Prokurorisë e Qeverisë është e patolerueshme. Grupi ynë parlamentar e shtroi këtë

çështje ditën e hënën 13 korrik, para Kuvendit, si çështje urgjente, por deputetët e kapur pas pushtetit korruptiv nuk pranuan ta fusnin në rend të ditës. Edhe Kuvendi duhet sa më parë ta trajtojë këtë çështje dhe të marrë qëndrim për ta ndaluar këtë kanosje të rendit e sigurisë në vend", ka reaguar Lëvizja Vetëvendosje.

Krasniqi zotohet se do t'i ketë prioritet prodhimet vendore

Pas rishqyrtimit të buxhetit të Kosovës do të nisë së zbatuari programi për rimëkëmbje ekonomike dhe në këtë formë bizneset do të mbështeten nga Qeveria e Kosovës. Angazhimi në mbrojtje dhe mbështetje të bizneseve është dhe do të mbetet prioritet, ka deklaruar ministri Krasniqi

PRISHTINË, 15 KORRIK - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur sot në një takim përfaqësuesit e Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit të Kosovës, të cilët kanë shprehur shqetësimet e tyre dhe vështirësitë me të cilat po përballen në këtë kohë pandemie.

Ministri Krasniqi ka theksuar se fokus i tij dhe ministrisë që

drejton janë prodhimet vendore dhe se mbështetja ndaj prodhuesve nuk do të mungojë, e sidomos në këtë kohë të pandemisë.

"Pas rishqyrtimit të buxhetit të Kosovës do të nisë së zbatuari programi për rimëkëmbje ekonomike dhe në këtë formë bizneset do të mbështeten nga Qeveria e Kosovës. Angazhimi në mbrojtje dhe mbështetje të

bizneseve është dhe do të mbetet prioritet", ka deklaruar ministri Krasniqi.

Ndërsa kryetari i Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit të Kosovës, Milazim Berisha, ka falënderuar ministrin për gatishmërinë e treguar. Berisha ka përmendur edhe konkurrencën jolohale që është në tregun vendës. Në fund ministri u zotua se



bashkë me inspektorë dhe ekspertë të industrisë së ushqimit do të dalë në terren

për t'i parë nga afër problemet e ngritura nga prodhuesit e qumështit.

Latifi ua mundëson mërgimtarëve që të hyjnë në oborrin e komunës me automjete private

Rahovec, 15 korrik (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka nënshkruar vendimin me të cilin u lejon të gjithë mërgimtarëve hyrjen në oborrin e komunës me automjete private që janë me tabela të huaja. "Pika 1 e vendimit thotë se u lejonet të gjithë mërgimtarëve hyrja në oborrin e komunës me automjete private, që janë me tabela të huaja si dhe atyre të marra me qira (rent a car) në Republikën e Kosovës. Kurse pika 2 e vendim-

it thotë se hyrja e mërgimtarëve në oborrin e komunës me tabela të huaja dhe atyre të marra me qira (rent a car) lejohet nga data 15 korrik 2020 deri më datë 15 gusht 2020. Ndërsa pika 3 e vendimit thotë se punonjëseve të administratës dhe drejtorëve të drejtorive komunale në Komunën e Rahovecit u ndalohej hyrja me automjete private në oborrin e komunës gjatë kësaj periudhe të cekur në pikën 2 të vendimit", thuhet në vendimin e kryetarit

Latifi.

Bazuar në pikën 4 të vendimit për zbatimin, do të përkujdeset Drejtoria për Administratë dhe punonjësi i portës. "Pika 5 thotë se mosrespektimi i këtij vendimi do të konsiderohet shkelje e kodit të mirësjelljes dhe do të merren masa konform ligjeve si dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Pika e fundit, pika 6, thotë se vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit", theksohet në këtë vendim.



Gjilani nënshkruan marrëveshje me korporatën gjermane për vendosjen e 200 kontejnerëve



GJILAN, 15 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nënshkruar marrëveshje me korporatën gjermane "Solar Outdoor Media G.M.B.H", për vendosjen e 200 kontejnerëve të avancuar për mbeturina në pjesë urbane të qytetit, në vlerë prej 400 mijë eurosh, që është në interes të mbrojtjes së ambientit dhe interes publik.

Pas nënshkrimit të aneksmarrëveshjes, Haziri ka thënë se kjo ka të bëjë me shtyrjen e afateve kohore të implementimit të marrëveshjes fillestare për shkak të pandemisë Covid-19, e cila ka bërë që "Solar Outdoor Media Kosovo-L.L.C" të jetë e ndikuar nga masat e

marra në nivel evropian për parandalimin dhe luftimin e pandemisë. "Kjo situatë ka pamundësuar prodhimin si dhe transportimin me kohë të kontejnerëve, prandaj aneksmarrëveshja është për shtyrje të këtij afati", ka thënë Haziri. Zbatimi i kësaj marrëveshje, sipas planit për vendosjen e tyre, do të fillojë në muajin shtator të këtij viti dhe projekti do të zgjasë deri në shtator të vitit 2021.

Komuna e Gjilanit mirëpret investitorët e huaj dhe punon vazhdimisht për krijimin e kushteve më të mira për investime duke krijuar kështu ura lidhëse me partnerët dhe donatorët e shumtë nga vende të ndryshme.

Tahiri takohet me Gjinin, ofron përkrahjen e qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike në Gjakovë

GJAKOVË, 15 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri i parë i Republikës së Kosovës, Besnik Tahiri, ka vizituar të mërkurën Komunën e Gjakovës, ku është pritur nga kryetari i komunës, Ardian Gjini. Në këtë takim është biseduar për menaxhimin e situatës së pandemisë Covid-19 dhe për çështje të tjera zhvillimore në nivelin komunal. Zëvendëskryeministri Tahiri ka falënderuar kryetarin Gjini për punën e palodhshme, frytet e së cilës po karakterizojnë Gjakovën si model të qeverisjes së mirë. Në takim është diskutuar për

planin e rimëkëmbjes ekonomike të Komunës së Gjakovës, me ç'rast zëvendëskryeministri Tahiri shprehu gatishmërinë e tij për të ndihmuar me të gjithë mekanizmat qeverisës. "Është kënaqësi të shoh se Gjakova sot po frymon ndryshe dhe nuk ka ndalur punën edhe në pandemi, por me vizion të qartë ka vazhduar me energji të plotë përmbushjen e synimeve të tyre. E di që komunat e Kosovës po përballen me sfida, por nuk do të ndalen përpjekjet për t'i evituar ato", ka thënë zëvendëskryeministri Tahiri.



Humanity First Kosova ndihmon në dezinfektimin e QPS të Prishtinës

PRISHTINË, 15 KORRIK (ER) - Disa prej punonjësve të Qendrës për Punë Sociale të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Prishtinës kanë rezultuar pozitiv me virusin Covid-19.

Nisur nga rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe me qëllim të ruajtjes së shëndetit të punonjësve dhe të palëve, të mërkurën janë dezinfektuar të gjitha njësitë e

Qendrës për Punë Sociale. Gjithashtu, javën që lamë pas Humanity First Kosova, në bashkëpunim institucional me Komunën e Prishtinës në të njëjtat hapësira, ka vendosur stacionet për dezinfektim dhe

maska.

Humanity First Kosova ka njoftuar se do t'i qëndrojë pranë Komunës së Prishtinës dhe institucioneve të tjera, duke u ofruar sadopak mbështetje për ta tejkaluar bashkërisht këtë sfidë.



EVROPA NUK ËSHTË MIRË TË GODASË MBI SHENJTËRINË E LUFTËS ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS



Shkruan: Kudusi LAMA

Unë personalisht e di që ndihma e Evropës për çlirimin e Kosovës deri në përfundim të goditjeve të NATO-s ka qenë thujse delikate, por unë kam dashtë që me këtë rast edhe Evropa ta marrë kthesën e të konsiderohet se i do shqiptarët si të gjithë qytetarët e saj, ndaj kam dashur që të konsiderohet edhe luftë e Evropës, ajo ndërhyrje e NATO-s. Por, siç duket, Evropa kur ndërhyri në Kosovë, nuk ndërhyri për t'i çliruar shqiptarët, por për t'i shpëtuar serbët. Edhe këtë unë e di dhe kam bindje profesionale dhe intelektuale se kjo ka qenë e vërtetë. Por, nëse ndodhi kjo, nuk do të thotë se ne ishim jashtë standardeve të jetës evropiane.

Unë di, gjithashtu, që në atë kohë shumë luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pasi kanë marrë plagë, janë bërë invalidë, ose kanë vdekur vetëm se nuk kanë pasur mundësi ta marrin ndihmën e shpejtë mjekësore, për mungesë medikamentesh e specialistësh. Ndërsa sot për hatër të serbëve e të Serbisë, Evropa shpif se ne paskemi pasur mundësi të instalojmë klinika aq moderne sa të bëjmë edhe transplantimin e organeve jetike njerëzore. Aq moderne sa Shqipëria edhe sot nuk po i realizon dot as te Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë, që është qendra më e avancuar mjekësore në Shqipëri.

Por asgjë nuk duhet të na habisë. Ky është një tregues i qartë se sa konsideratë ka pasur Evropa për luftën tonë, për lirinë tonë, për zhvillimin tonë dhe për të ardhmen tonë. Prandaj edhe na ofendojnë. Prandaj edhe kanë dëshirë të na e mohojnë luftën tonë.

Raporti i Dick Martyt është një mesazh se akoma bëhet një punë evropiane për Serbinë. Ai është një element prove, se akoma ndikimi serb mbi politikën evropiane është i pranishëm, se ka akoma influencë të fshehtë serbe në qarqe të nivelit të lartë në Evropë.

Por mua nuk më shqetëson dhe gjithë shqiptarët nuk duhet t'i shqetësojë një raport akuzues e përbuzës, i kujtudo qoftë. Por duhet të na shqetësojë fakti që Parlamenti i Evropës miratoi një rezolutë dhe nxori një deklaratë publike miratuese për këtë raport. E kërkoj ngritjen e një

gjkate speciale për t'i dënuar ata që akuzon pa asnjë fakt ky raport.

Patí edhe zëra që ishin njerëzorë dhe të drejtë në atë parlament, por mbisundoi përfundimisht politika sllave e serbe. Ata zëra u shpërfillën dhe nuk u morën në konsideratë. Më fort kumboi zëri i rusëve që akuzonin shqiptarët se sa i shqiptarëve që kishin vetëm një kërkesë: të mos barazoheshin me kriminelët, sepse ishin viktimat shekullore të kriminit jugosllav e serbë.

Duket se misioni është i qartë. Kjo rezolutë nuk është akuzë vetëm për Kosovën. Ajo është edhe për Shqipërinë dhe për të gjithë shqiptarët kudo që janë në trojet e tyre e në diasporë. Pra, shihet se kërkohet të thuhet që të mos vlerësohen shqiptarët, pasi ata janë të tillët që i kemi përbuzur gjithnjë dhe për hatër të serbëve e jugosllavëve duhet t'i përbuzim përsëri. Kërkohet të krijohet një pengesë e pakapërcyeshme për shqiptarët drejt Evropës. Dhe dihet që Evropa është shumë e ndjeshme kundër kriminit. Duke i quajtur shqiptarët kriminelë, kuptohet se i thuhet Evropës rri larg tyre. Ka shumë mundësi që të thuhet, se edhe Serbisë i takon shpërblim vështirësie që i ka masakruar prej gati dy shekujsh shqiptarët, qysh prej vitit 1846 e deri në vitin 1999. Se është lodhur duke i sunduar e shfrytëzuar për t'i mbajtur larg Evropës.

Evropa duhet të dijë se shqiptarët kanë gjëra të shenjta siç kanë të gjithë popujt dhe kombet e tjerë. Nuk është mirë të godasë pikërisht mbi këto shenjtëri, siç është edhe Lufta Çlirimtare e Kosovës. Ne kemi vlerat dhe historinë tonë për të cilat jemi të gatshëm të bëjmë edhe sakrificat. A nuk ka njohuri Evropa për vlerat e kombit shqiptar, apo nuk dëshiron të dijë? Mendoj që duhet të ketë njohuri, pasi unë kam njohuri për vlerat e italianëve, grekëve, francezëve, spanjollëve, portugezëve, anglezëve, skocezëve, skandinavëve, gjermanëve, austriakëve, hungarezëve, rusëve etj. Ata duhet të dinë për ne siç dimë ne për ata. Nëse jo, ky është tregues se ata janë të pa kulturuar jo ne. Prandaj, nëse ka evropianë që janë të pa kulturuar nuk janë fajtorë shqiptarët. Unë vetëm do t'u lutem atyre të studiojnë historinë dhe të njohin vlerat historike të kombit shqiptar dhe njëkohësisht të njohin edhe kontributet e këtij kombi për Evropën, për historinë, kulturën dhe sigurinë e saj.

Realisht Dick Marty nuk bëri mirë që u bë megafon i Serbisë. Por edhe pse u bë, kjo nuk është shumë problem. Ai përfaqëson vetëm vetveten. Por e keqja prapë e theksoj qëndron në

faktin që ai u morë shumë seriozisht nga Parlamenti Evropian. Unë nuk dua ta akuzoi atë. Por ai ka marrë në mbrojtje Serbinë, duke u munduar ta pastroi nga fashizimi i saj. Pse e bënë këtë? Unë nuk mund ta di. Por ai ose ka vetë në gjenin e tij ambicie fashiste, ose është paguar për të bërë justifikime të veprimtarisë fashiste të Serbisë. Në mjaft momente evropianët edhe janë fyer, pse ne shqiptarët kemi reaguar ndaj këtij raporti dhe këtij qëndrimi të Parlamentit Evropian. Është vërtetë i çuditshëm ky qëndrim. Ne, që na fyejnë e na denigrojnë, që na akuzojnë e na shpifin, që na përdhunojnë e na ngarkojnë, ne nuk duhet të flasim e të reagojmë se evropianët fyhen. S'ka gjë se ata na fyejnë. Ky vërtetë është një tregues i pabarazisë që kërkojnë të instalojnë evropianët. Nëse kjo është e vërtetë, Evropa qenka e padrejtë. Kështu nuk është mirë. Kur ne akuzohemi se qenkemi kanibalë, nuk është ndonjë problem. Por kur ne themi se këto akuza janë fashiste, Evropa fyhet. Le të fyhet, ato janë akuza për të justifikuar krimet fashiste dhe ai që justifikon fashizmin është më i keq se fashizmi.

Nëse Evropa trembet, unë them se koha e Pjetrit të Madh të Rosisë ka kaluar. Ani pse ai u ka thënë rusëve: "Futuni e merrni pjesë në çdo rast në çështjet dhe grindjet e Evropës e sidomos të Gjermanisë, e cila na intereson me drejtpërdrejt nga që ndodhet më pranë nesh". Ani pse ai i porositë rusët: "Përparoni pa u ndalur..."

Por duke njohur detyrat që kanë ruset prej paraardhësit të tyre të lavdishëm, besoj se bëhet e qartë për të gjithë evropianët që

sllavët nuk kënaqen me pak. Ata nuk kënaqen duke hedhur baltë evropianët mbi shqiptarët. Prandaj evropianët mos të mundohen t'i mashtrojnë. Ata, le të mbrojnë veten prej tyre, se vërtetë janë të rrezikuar. Me diplomaci mashtruese nuk mund të ecet. Diplomacia ka vlerë kur vendos drejtësi.

Realisht Serbia është e sëmure dhe Evropa me qëndrime kundërshqiptare nuk mund ta shërojë kurrë. Atë mund ta shërojë vetëm kur t'i thuhet e vërteta, që është e njëjlojtë me kombet e tjera. Kur t'i thuhet se me përvetësim pronash e historie të të tjerëve nuk mund të jetë një shtet i madh. T'i thuhet se kisha nuk është pronë serbe, por është institucion shpirtëror individual njerëzor, nëpërmjet të cilës vendosen marrëdhëniet midis njerëzve dhe Zotit. A mos edhe Zotin serbët e kanë vetëm për vete? Deri këtu duket se shkon absurditeti serbë e jugosllav e miratimi evropianë.

Të mbajmë në vëmendje se serbët me bekimin e Rosisë e mbështetjen e drejtpërdrejtë të saj, akoma mendojnë si Milosheviqi se "Kosova është tokë serbe, asnjëherë nuk ka qenë shqiptare e as që do të jetë ndonjëherë!" Këtë mendim kanë edhe autoritetet politike e shtetërore serbe dhe kisha e Serbisë aktualisht, të cilët mendojnë e veprojnë me të gjitha mënyrat për të gjetur rrugë të mundshme për ta vënë Kosovën përsëri nën kontrollin serbë. Evropa mendoj se nuk duhet të tentojë të bëhet mashë e Serbisë në këtë aventurë, pasi dihet se aventurat janë të destinuara të dështojnë gjithnjë. Serbët kanë qenë dhe mbeten

burim konfliktesh të vazhdueshme me fqinjët prej shekujsh; racist e fashist deri në ekstrem, duke mos pranuar asnjë fqinjë të barabartë me veten, këtë e vërtetojnë programet e tyre të kërkimit të të drejtave historike të kombinuara me të drejtën racore serbe; ultraekstremist deri në ndërhyrje në punët e Perëndisë, nëpërmjet krijimit të miteve të paqena dhe deklarimin e popullit serb si një popull të dashur të Zotit mbi popujt e tjerë; misticizues të shkencës kanë krijuar një kompleks skizofrenësh, të cilët gjatë historisë, humbjet i shohin si fitore; burim i ideologjisë serbomadhe që ka prodhuar e do të prodhojë vetëm shovinizëm, destruktivitet, përlëshje e keqdashje; as që mendoj se mund e do të reformohen e bëhen modern e mirëdashës të të tjerëve. Por siç duket për efekte balancimi Evropa po vazhdon t'i përkëdhelë akoma ata. Ama, jo më në dëm të shqiptarëve e trojeve të tyre, u bë shumë. Evropa duhet të kuptojë që midis shqiptarëve e serbëve është një lum gjaku shqiptar. Ky gjak nuk mund të bëhet ujë kur të dojë Evropa. Ai është dhe mbetet gjak. Nëse evropianët kanë nderim për gjakun e tyre, duhet të kenë të qartë dhe edhe gjaku i shqiptarëve i kuq është si ai i evropianëve. Nëse Serbia e serbët dhe gjithë sllavët do të dinë ta respektojnë e nderojnë atë gjak se i ka çliruar nga vetvetja, mund t'i mirëkuptojnë edhe shqiptarët, por me presione, akuza e kërcënime edhe Evropiane, nuk mendoj se shqiptarët duhet të tremben se Evropa është e shqiptarëve aq sa edhe e serbëve. Këtë është mirë ta dijë Evropa e para. (Vijon)



Në Dhomën e Përfaqësuesve në ShBA dërgohet rezolutë që dënon gjenocidin në Srebrenicë

NJU JORK, 15 KORRIK - Anëtarja e Dhomës së Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara, Eddie Bernice Johnson, i dërgoi një rezolutë kësaj dhome, e cila e dënon gjenocidin dhe krimet e tjera kundër boshnjakëve, të kryera nga forcat serbe në Srebrenicë të Bosnjës, në korrik të vitit 1995.

Rezoluta që u dërgua në Komitetin për Forca të Armatosura u mbështet edhe nga dy kolegët e saj demokratë, Eliot Engel dhe James McGovern.

Në rezolutë thuhet se, nisur nga prilli i vitit 1992, forcat serbe të Bosnjës, të mbështetura nga forcat ushtarake dhe paraushtarake serbe, kanë kryer agresion dhe spastrim etnik. Sipas rezolutës, marrja e

kontrollit të territorit përreth Srebrenicës ka rezultuar me një fluks masiv të boshnjakëve që kanë kërkuar mbrojtje brenda dhe përreth Srebrenicës, të cilën Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e ka shpallur "zonë të mbrojtur" me rezolutën 819, në prill të vitit 1993. "Forcat serbe të Bosnjës kanë dëbuar gra, fëmijë dhe të moshuar me autobusë, por kanë mbajtur më shumë se 8 000 burra dhe djem, kryesisht boshnjakë, në kampe përqendrimi nën kontrollin e tyre, pastaj i kanë ekzekutuar të burgosurit dhe i kanë varrosur në varreza masive", thuhet në rezolutë.

Aty, po ashtu, theksohet se Slobodan Millosheviq dhe Qeveria e atëhershme e



Jugosllavisë e kanë mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë spastrimin etnik, që ka çuar në mbi dy milionë njerëz të zhvendosur, mbi 100 000 të vrarë, dhjetëra-mijëra të dhunuar, torturuar dhe

abuzuar. "Disa zyrtarë të Serbisë dhe të serbëve të Bosnjës, përfshirë anëtarin aktual të Presidencës së Bosnje dhe Hercegovinës, Millorad Dodik, në mënyrë të rreme e etiketojnë gjenocidin në

Srebrenicë si 'mit të fabrikuar dhe si mashtrimin më të madh të shekullit 20'', thuhet në rezolutë.

Në fund të saj dënohet gjenocidi i kryer nga forcat serbe në Bosnje dhe dënohen deklaratat, aktet dhe politikat që e vënë në dyshim gjenocidin, ndërsa ShBA-së i bëhet thirrje që ta ndjekë politikën, e cila mbështet sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnje dhe Hercegovinës dhe u bënë thirrje të gjithë udhëheqësve politikë që ta ndalojnë përdorimin e retorikës së ndarjes për të arritur qëllime afatshkurtra.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë ka konstatuar në vitin 2007 se vrasjet në Srebrenicë kanë përbërë gjenocid.

Vaksina e ShBA-së kundër Covid-19 jep shenja premtuese



NJU JORK, 15 KORRIK - Firma bioteknike amerikane "Moderna" ka njoftuar se vaksina e saj eksperimentale kundër Covid-19 ishte e padëmshme dhe nxiti përgjigje imune te të 45 vullnetarët e shëndetshëm, që morën pjesë në një studim të fazës së hershme. Qeveria e Shteteve të Bashkuara e mbështet vaksinën e "Modernas", e cila së shpejti do të hyjë në fazën e fundit të testimit klinik.

"Moderna" ka njoftuar se synon të regjistrojë rreth 30 000 njerëz për testimin e fazës së tretë që nis më 27 korrik. Dhjetëra vaksina kundër Covid-19 janë në faza të ndryshme të testimit në gjithë botën. Anthony Fauci, drejtor i Institutit Kombëtar të ShBA-së për Alergjia dhe Sëmundje Infektive, ka shprehur "optimizëm të kujdesshëm" se së paku një vaksinë do të mund të zhvillohet deri në fund të

këtij viti apo në fillim të vitit 2021.

Koronavirusi ka prekur mbi 13.3 milionë njerëz në gjithë botën. Prej tyre, mbi 578 000 kanë vdekur dhe mbi 7.3 milionë janë shëruar. Vendet më të prekura janë Shtetet e Bashkuara dhe Brazili, që kanë numrin më të madh të të infektuarve dhe viktimave në botë. Në Evropë, vendi më i prekur është Mbretëria e Bashkuar.

Mbi 1 milion njerëz e kanë lënë duhanin në Britani

LONDËR, 15 KORRIK - Më shumë se një milion njerëz mund të kenë hequr dorë nga pirja e duhanit prejse ka shpërthyer pandemia e koronavirusit në Mbretërinë e Bashkuar, thotë një studim i organizatës Aksion për Duhanpirjen dhe Shëndetin, me seli në Londër. Nga ata që kanë lënë duhanin në katër muajt e mëparshëm, 41 për qind kanë thënë se ky vendim ishte përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj koronavirusit.

Aksioni për Duhanpirjen dhe Shëndetin ka njoftuar se sondazhi është kryer në periudhën 15 prill - 20 qershor, me një mostër përfaqësuese prej 10 000 personash. "Mbi një milion duhanpirës mund të kenë arritur ta ndalojnë duhanin qëkur Covid-19 [sëmundja që shkakton koronavirusit] ka goditur Britaninë, por miliona të tjerë kanë vazhduar duhanpirjen", ka thënë drejtoresha e organizatës, Deborah Arnott.



Rreth 7 milionë njerëz në Mbretërinë e Bashkuar kanë qenë duhanpirës në vitin 2019. Në një tjetër studim, Kolegji Universitar i Londrës ka konstatuar se më shumë njerëz e kanë lënë duhanin këtë vit, deri në qershor, sesa në çdo vit tjetër, prejse kanë filluar sondazhet e tilla në vitin 2007. Sipas këshillave të Qeverisë britanike, duhanpirësit mund të jenë të rrezikuar nga simptoma më të rënda të sëmundjes Covid-19.

KE-ja: Evropa duhet ta nisë më herët vaksinimin kundër gripit

BRUKSEL, 15 KORRIK - Komisioni Evropian ka theksuar se Shtetet e Bashkuara Evropian duhet të nisin më herët fushatën më të mëdha të vaksinimit kundër gripit, për ta ulur rrezikun e shpërthimeve të njëkohshme të influencës dhe të Covid-19.

Fushatat për vaksinim kundër gripit normalisht fillojnë në vjeshtë, por sivjet këshillohet që ato të fillojnë gjatë verës.

Zyrtarët e BE-së janë të shqetësuar se spitalet mund të mbingarkohen nga një numër i madh pacientësh, siç ka ndodhur në kulmin e pandemisë së koronavirusit në Evropë, gjatë muajve mars dhe prill.

Komisioni Evropian, po ashtu, u bëri thirrje shteteve që të blejnë më shumë vaksina kundër gripit. Këtë javë shkencëtarët në

Mbretërinë e Bashkuar kanë paralajmëruar se vala tjetër e koronavirusit në dimër mund të jetë më vdekjeprurëse. Sipas tyre, Mbretëria e Bashkuar mund të shohë rreth 120 000 vdekje të tjera nga koronavirusi në dimër. Aktualisht, Mbretëria e Bashkuar është vendi më i prekur në Evropë nga Covid-19: me mbi 292 000 të infektuar dhe mbi 45 000 viktime.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten free

100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues

E jashtëzakonshme

Fshati pa rrugë



Fshati Giethoorn, gjithashtu i njohur si "Venecia e Hollandës", është një vend shumë magjik që ishte zbuluar në vitin 1230. Shumë njerëz ëndërrojnë të jetojnë në vende të tilla, sidomos për

ajrin e pastër që ka dhe pamjen fantastike. Fshati nuk ka rrugë, që do të thotë se nuk ka asnjë mjet të transportit të zhvilluar rreth tij. Njerëzit që dëshirojnë ta vizitojnë fshatin duhet t'i lënë veturat

e tyre jashtë dhe të ecin. I vetmi transport që mund të përdorni është të ecni, biçikleta apo të merrni një varkë të vogël. Giethoorn është i mbushur me kanale dhe krijojnë një pamje të bukur.

BARSOLETA E DITËS



E dashura: Shpirt, më duket vetja shumë e shëndoshë, e shëmtuar dhe e plakur.
I dashuri: Edhe?
E dashura: Të lutem ma bëj një kompliment.
I dashuri: Zemër, ke shikim shumë të mirë.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

E rrallë

Burri mban një grumbull bletësh në dorë

Një burrë ka vendosur ta mbulojë dorën me bletë, e ta incizojë më pas atë çast. Siç shpjegon "Daily Mail", ai i gjeti një grumbull bletësh përpara shtëpisë së vet, kështu që vendosi t'i largojë ato, duke i vënë në dorë. Përkundër faktit se ato mund ta kafshonin nga momenti në moment, ai vazhdon me konsistencë të plotë t'i lë në dorën e tij të djathtë.



FOTO E DITES



Disa djem në Pakistan mbulojnë kokën me qese najloni për t'u mbrojtur nga shiu. /AP/

E rrallë

Blokohet në shilarëse për fëmijë teksa xhironte video për TikTok, adoleshenten e shpëtojnë zjarrfikësit

Një vajzë adoleshente ka kërkuar ndihmën e zjarrfikësve pasi ngeci në një shilarëse fëmijësh duke xhiruar një video për TikTok.

14-vjeçarja Layani Maclean ndenji 1 orë e gjysmë në shilarëse përpara se ta ndihmonin për të dalë nga aty. Ngjarja ndodhi në Oksford të Anglisë.

Një nga zjarrfikësit i tha vajzës me shaka: "Pa merak, nëse nuk



je e famshme në TikTok, do të bëhesh e famshme te departamenti ynë".



DASHI
Mos i shpenzoni energjitë

për çështje të ndryshme, por fokusohuni vetëm tek ato më kryesoret.



DEMI
Veproni me qetësi dhe

zgjuaresi për të arritur ato çfarë dëshironi. Optimizmi është receta e duhur për problemet tuaja.



BINJAKËT
Do të keni dëshirë të hiqni dorë

nga disa gjëra dhe të shkoni në një ishull të qetë për t'u relaksuar.



GAFORRJA
Nëse takoni njerëz të

rinj tregohuni vetvetja, të hapur dhe të sqartë, por mos tregoni më shumë seç duhet rreth vetes.



LUANI
Është dita e duhur për

të bërë eksperimente, madje mund të provoni edhe gjëra të jashtëzakonshme.



VIRGJËRËSHA
Është dita e duhur për të bërë blerje

të ndryshme. Nëse nuk do të ndiheni mirë nga ana shëndetësore, rekomandohet të shkoni menjëherë te doktori.



PESHORJA
Kjo ditë premtan shumë fat.

Madje ekziston mundësia që të gjeni një vend të ri pune prestigjioz dhe me të ardhura më të larta.



AKREPI
Ekziston mundësia të dështoni në një inter-

vistë pune. Megjithatë, mblidhni forcat për të ecur përpara, pasi është e vetmja mënyrë për t'ia dalë mbanë.



SHIGJETARI
Nuk pritet të keni ndonjë problem

gjatë kësaj dite. Përpjekjet tuaja të shumta në fusha të ndryshme do t'i shfaqin rezultatet që ju kërkoni.



BRICJAPI
Një lajm i mirë lidhur me

karrierën dhe financat tuaja është në ardhje. Mund t'ju rritet paga mujore ose të zini një pozicion të ri pune.



UJORI
Nuk rekomandohet të zhvilloni

takime në grupe të mëdha. Mos hezitoni të shprehni çdo ide tuajën, sado e çuditshme mund të duket.



PESHQIT
Bëni një lëvizje kundrejt

ëndrrave tuaja. Përdorni gjithë energjitë tuaja për ta arritur atë. Megjithatë, ka gjasa që në këtë drejtim t'ju ndihmojë edhe fati.

Dorëzohet Kanye West, heq dorë nga gara për president



Kanye West thuhet se është tërhequr nga gara presidenciale e ShBA-së, më pak se dy javë pasi njoftoi se ai do të kandidojë. Anëtari i ekipit të fushatës së Westit, Steve Kramer, raportohet të ketë thënë për revistën

“Intelligencer” se reperi më nuk do të garojë në zgjedhje. “Ai është jashtë gare”, i ka thënë Kramer, “Intelligencer”. Kramer nuk specifikoi arsyet e Westit për gjoja tërheqje, por tha se ai do ta “njoftojë [Intelligencer] atë që të gjitha gjërat tona u anuluan”.

Rihanna ka një surprizë për femrat, linjën e re kozmetike të Fenty Beauty



Rihanna është një këngëtare e famshme, por që së fundi është angazhuar më shumë me aktivitetin e saj si sipermarrëse. 32-vjeçarja, që ka linjën e saj te Fenty Beauty, ka zbuluar se koleksioni i ri i

produkteve për lëkurën, Fenty Skin, do të dalë në treg më 31 korrik. Rihanna bëri njoftimin emocionues me video, ku shihet teksa aplikon disa produkte për lëkurën, si serumi, një pastrues dhe krem dielli.



Justini i dashuruar kokë e këmbë

Justini ende nuk beson se Hailey e zgjodhi atë për partner. Një ndër çiftet më të komentuar të shoubizit janë edhe Justin dhe Hailey Bieber. Pas romancave të mëparshme të këngëtarit, pakkush kishte besuar se këta të dy do të martohen. Por, tani ata janë


më se të lumtur pranë njëri-tjetrit dhe nuk i kursejnë as dedikimet publike me fjalë dashurie. “Ende nuk mund të besoj se më zgjodhe mua”, ka shkruar Justini në rrjetet sociale në fotografinë e fundit, ku modeluesja shfaqet në prehrin e tij.

George Clooney, një baba singëll



Nuk do t'i kalojë pushimet si çdo vit në liqenin e Comos me të gjithë familjen? Është hera e parë që aktori amerikan George Clooney braktis Italinë dhe qëndron në Los Anxhelos, ku duket se po jeton një çast krize me bashkëshorten Amal

Alamuddin. Fotografët e revistës ‘Chi’ e kanë fotografuar vetëm me një prej binjakëve të tij teksa shkonte te pediatri. Me një shall që i mbulon hundën dhe gojën, me xhinse dhe bluzë blu dhe në dukje i shqetësuar dhe shumë serioz.



Si u dha çmimi i parë Nobel për Letërsinë

Pas shumë hezitimesh, diskutimesh, zvarritjesh dhe pikëpyetjesh edhe pa përgjigje, Akademia suedeze, i jep më 1901 dhe për herë të parë Çmimin Nobel të Letërsisë, Sully Prudhomme, René-François Prudhomme, anëtar i Akademisë franceze. Vendimi u bë publik në Stokholm, më 10 dhjetor 1901.

Ja si shkruan një nga gazetaret suedeze: "Pra nuk zgjidhet as Tolstoi, as Ibsen, as Björnson, as Mommsen, as Swinburne, as Zola, as Anatole France, as Carducci, as Mistral, as Hauptmann as edhe Echegaray, por zgjidhet Sully Prudhomme". Ky konstatim, me negativitet si dhe me hamendjet e tij, fsheh një debat të gjatë në vazhdim. Ai shfaq një farë situatë të brendshme të vendit i cili jep Çmimin, dhe po ashtu ndriçon në një farë mënyre, situatën letrare në vendin e fituesit.

Duke parë se Franca ishte zgjedhur vendi i cili dukej që do të priste dhënien e Çmimit, brezat e ardhshëm mund të pyesin se përse nuk iu dha Zolës apo Anatole France. Kritika letrare foli për një gjuhë ndryshe të përdorur nga personalitetet e kohës. Çmimi Nobel, ishte një terren i veçantë, i mbjellë nga një tokë akademike, me mendimtarë të rëndësishëm brez pas brezi, me njohuri të rrënjësura nga një ideal thelbësor.

Për shumë vite me radhë, fjala "ideal" diku e rrezikshme, duhej

patjetër të luante një rol tepër të rëndësishëm në diskutimet relative për dhënien e Çmimit, duke u peshuar mirë në zgjedhjen e kandidatëve fitues. Në kohën kur Alfred Nobel kishte rezervuar në testamentin e tij një çmim për letërsinë, përkrah asaj të mjekësisë, fizikës, kimisë dhe të veprave në favor të Paqes, çmimi i Letërsisë duhej dhënë nga "Akademia".

Ky autorizim, i dha të drejtën dhe ia besoi detyrën, Akademisë suedeze, kësaj asamblejeje të rëndësishme, e cila ishte krijuar që më 1786 nga "Roi Soleil" (Mbreti i diellit) të Suedisë, Gustave III, mbështetur në përvojën e Akademisë franceze. Në fillimet e saj, kjo detyrë e papritur, u ndesh përballë situatave të vështira. Akademia presupozohej të kishte detyrime kombëtare të rëndësishme, drejt letërsisë dhe gjuhës suedeze, por jo të merrte përsipër rolin e ndërgjegjësimit internacional.

Po ashtu, Akademia u përball me komente keqdashëse ndaj literaturës së re. Viheshin në dyshim kompetencat e Akademisë.

Shpirti i saj konservator tradicional ishte në kundërshtim me letërsinë e vërtetë realiste e cila ishte kapur rreth veprave të August Strindberg në epokën e Ibsenit dhe të Björnsonit. Po ashtu, kishin filluar ta konsideronin Akademinë si një ngatërresë në rritje dhe një reagim drejt obskurantizmit.

Kjo ishte arsyeja që u bënë përpjekje për kalimin e vështirësive duke u kërkuar zgjidhje të reja për misionin tepër delikat. Në vitin 1900 u hap biblioteka e cila do të ndiqte zhvillim e literaturës botërore, dhe mes anëtarëve të Akademisë, u krijua një Komitet special i ngarkuar të punonte për përgatitjen e dhënies së çmimit. Thembra e Akilit ishte Sekretari i Përgjithshëm i Akademisë, Dr. Carl David af Wirsén. Si poet ai ishte tepër kërkues, katolik dhe po aq paqësor.

Si kritik i letërsisë moderne, kishte një karakter luftarak. Në gjirin e Komitetit të Akademisë ai përballonte një punë të madhe dhe shumë shpejt mori masa administrative. Mbështetur në rregulloren e vendosur për dhënien e çmimit, të gjitha aktet e kandidaturave duhet t'i nënshtroheshin kontrollit të Akademisë suedeze nga Akademia franceze, spanjolle dhe suedeze; sekretarët e burimeve njerëzore të Akademive të tjera; anëtarë të institucioneve dhe shoqatave të ngjashme me Akademinë, nga profesorë të universiteteve, mësues të estetikës, të letërsisë dhe historisë.

Pra, kjo nuk përbëhej nga një trup i vogël elektoral, dhe ndaj u duheshin notifikuar të drejtat e tyre. Për këtë arsye u hartuan dhe shpërndanë fletoret zyrtare në gjuhën gjermane, angleze dhe franceze, të cilat u dërguan me

zell në katër pikat më të rëndësishme. Propozimet duhet t'i paraqiteshin Akademisë para 1 shkurtit 1901. Rrjeta u hodh në gjithë Europën dijetare. U prit me muaj të kapej peshku i gjetur. Hap pas hapi filluan të vijnë përgjigjet nga njëri vend në tjetrin. Ato filluan të analizohen nën fshehtësinë më të madhe. Kërshëria rritej dhe kjo për arsye që kuptoheshin. Bëhej fjalë për një shumë të konsiderueshme të hollash në jetën letrare. "Shkrimtarët e huaj për herë të parë, fillojnë të shohin larg, drejt Akademisë në Stokholm", shkruante një figurë e shquar suedeze. "Në gjithë botën, njerëzit e letrave filluan të presin me padurim mbi cilën muzë Danaë, Këshilli suedez, do të derdhte lumin e arit?"

Tani, pas kaq vitesh, kur mund të zbulojmë sekretin e fshehur prej kohësh nëpër dokumentet e vjetra, jemi të lumtur të ndjekim çdo etapë mbështetur në ato që dëshmojnë. Bëhej fjalë për një anketë internacionale, të pa parë ndonjëherë, dhe konstatohet me kënaqësi që Akademia e vogël e mjekrave të bardha (të vjetra) kaq herë e kritikuar, po shfaqej plotësisht në lartësinë e duhur për misionin e saj të vështirë e fisnik.

Të gjitha përgjigjet e ardhura nga vendet e ndryshme me fletoren zyrtare, ishin regjistruar me kujdes sipas rendit alfabetik të dërguesve për t'u shpërndarë më pas të rikopjuara, tek gjithë

anëtarët e Akademisë, në përgjithësi dhe Komitetit Nobel në veçanti.

Në krah të Sekretarit të Përgjithshëm me shpirt luftarak, ndodhej një profesor i historisë tepër i njohur në gjuhën romane, po ashtu në letërsi; gjuhëtar i shquar i gjuhëve skandinave herë pasardhës e herë homonim i Esaias Tégner, "mjekra klasike" e Suedisë, i vetmi poet cilësor, Konti Carl Snoilsky, drejtor i Bibliotekës mbretërore të Stokholmit.

Fletët e grumbulluara njëra pas tjetrës mbi tavolinat e Akademisë suedeze, japin në një farë mënyre imazhin tipik të letërsisë europiane, në fillim të shekullit.

Britania e madhe, ky vend ishullor, gjithmonë i rezervuar, paraqitet një njollë e bardhë në hartë. Asnjë propozim, asnjë emër i shënuar. Polonia prezantohet hijshëm me Henry Sienkiewicz kandidatura e të cilit mbrohej me inteligjencë nga dy historianë të njohur suedez.

Gjermania një vend me kokën pas nga impulset energjike të Guillaume II, kërkon t'i dëgjohet zëri në një dokument (plein d'emphase). Një profesor në Dresde rekomandon me forcë që të merret në konsideratë një këngëtar pothuajse i panjohur, për "talentin e tij lirik tepër të madh".

Po ashtu një grup i shoqëruar nga një figurë e njohur në fushën e historisë, një shtytje e madhe e

shkencës emri i të cilit sot është bërë i njohur nga publikimet klasike. Gjuhëtari roman, me në krye profesorin e vjetër të Ienas, W.Cloetta, e kthejnë kokën nga bregu i Rinit dhe i Ronit duke tërhequr vëmendjen tek një poet provincial Frédéric Mistral. Përballë këtyre veprimeve të shpërndara, shpesh me kërshëri, siguria e rutinës bie në përgjigjet e herëpashershme të Francës, vend nga i cili prej shumë kohësh, jemi mësuar të marrim të veçanta akademike të rekomanduara.

I madhi Marcelin Berthelot nuk ka nevojë për shumë fjalë në prezantimin e kandidaturës së Emil Zolas; I zgjedhur në Akademinë franceze më 1900, në cilësinë e anëtarit, propozon një shkrimtar të frymëzuar nga shkencat natyrale dhe liberalizmi demokratik. Edmond Rostand nuk ka nevojë as ai për elozhe të shumta : u propozua nga Paul Hervieu në garancinë e Cyrano de Bergerac dhe Aiglon. Gjithçka është shprehur qartë dhe në mënyrë të përmbledhur. Përsëri fjalë e argumente disi më të ngatërruara, i janë kushtuar një tjetër kandidati ku dukej hapur mbështetja energjike dhe një marrëdhënie sigurie e padiskutueshme

Larg hapësirave të Parnasse, pak i njohur si jashtë si edhe në Suedi, bëhej fjalë për René Vallery-Radoti, cili u bë shkak i një veprimi të bashkërenduar në favor të biografisë së vjehrrit të tij "Jeta e një Pastori".

Duke qenë se ishte nipi i Eugène Sue dhe Emile Legouvé, bashkëpunëtori i parë i Buloz tek "Revue des deux Monde", (Revista e dy Botëve) ai ishte familjarizuar me sukseset e letërsisë. Nuk do të gabohej supozimi që prania e tij mes nobelistëve rezulton si goditje e fortë alarmi. Ai u propozua si fillim nga Melchior de Vogué, më pas Stokholmi u bombardua në disa ditë rresht, nga tekste të mrekullueshme, miratuar nga figura të njohura si Ernest Legouvé, Albert Vandal, Gabriel Hanotaux, Albert Sorel, Sully Prudhomme e Henri Lavedan. Të gjithë shfaqin mendimin se "Jeta e një Pastori" është një vepër letrare e jashtëzakonshme në kuptimin e idealizmit. Zhurma e kësaj fushate kishte mbërritur deri në Paris u hapi rrugën manifestimeve të pakënaqësisë nga ana e Kolegjit të Francës ku Paul Meyer rekomandon Mistral, me një shënim anësor "Vallery-Radot propozuar nga Vogué, është një arritje...".

Një rrëmujë e tillë nuk kishte gjë tjetër për qëllim, veçse të shpërqendronte vëmendjen e Komitetit. Efekti i tij, në fakt u ekuilibrua nga Akademia - simotër e Parisit-e cila gjeti mbështetje nga firma të tjera letrare, me propozimin e një kandidature fisnike, e shkallës së parë.

Sully Prudhomme hyn mes kandidaturave të nobelistëve nga

një tekst tepër i rëndësishëm datuar më 10 janar 1901 dhe firmosur nga Gaston Paris, Gréard, Paul Bourget, Gaston Boissier, André Theuriet, Henry Houssaye, François Coppée, Ludovic Halévy, Henri de Bornier, José-Maria de Hérédia, Jules Lemaitre, C.de Freycinet e Emille Deschanel. Tekst aprovohet po ashtu edhe nga Emile Olivier, Costa de Beauregard e Emile Faguet.

Ky manifestim masiv i natyrës gjysmë zyrtare, eklipsoi në votimin e shpërndarë shteteve të tjera si Italia, Greqia, Norvegjia madje dhe vetë Suedia ku Gaston Paris ishte rekomanduar nga një kolegët e tij adhurues, në Universitetin e Upsalas.

Me gjithë këto ndërhyrje të gjata, zgjedhja nuk ishte dhe aq e vështirë, ku pas marrjes së vendimit përfundimtar nga Akademia në një seancë plenare më 14 nëntor, Sully Prudhomme, u lajmërua se çmimi i ishte akorduar "në mirënjohje të meritave të veçanta që ai ka treguar si autor deri në vitet e fundit, dhe në veçanti për poezinë e tij e cila dëshmon një idealizëm të arrirë, në një përsosmëri artistike dhe me një ndërthurje kaq të rrallë të cilësive të shpirtit dhe të gjenit".

Që në 19 nëntor mbërriti një letër me një përgjigje tepër elegante ardhur nga Châtenay, vendi ku ai banonte. "Ndiej krenari të pakufishme dhe lumturohem duke menduar nderin e një instance kaq të lartë dhe kërkuar nga shumë shkrimtarë të tjerë më lartë se unë, kjo fitore i shkon atdheu tim, të cilit i detyrohem për këtë nderim e vlerësim të veprës sime".

Dhe duke qenë se këtu nuk bëhet fjalë vetëm për fitore, por edhe 208.950 franga, fituesi jep me kënaqësi të dhënat e llogarisë së bankës në Paris.

Publiku nuk ishte ende në dijeni dhe fituesit i ishte lutur, të mbante fshehtësinë, derisa të behej dorëzimi zyrtar i çmimit më 10 dhjetor, datë e vdekjes së Alfred Nobel.

Dihej mirë që profesor Roentgen, ndodhej në Grand Hotel, dhe prania e tij kuptohej, ishte e justifikuar për Çmimin në Fizikë. Vetëm të ftuarit e dinin që ambientet për letërsinë nuk do të ziheshin.

Që në fillim, Sully Prudhomme, kishte deklaruar se për arsye të një sëmundjeje të gjatë, nuk mund të paraqitej. Kjo në fakt i prishte pak planet e organizimit. Prania e tij nën uniformë, natyrisht që do të bënte efektin e vetë të veçantë gjatë ceremonisë. Nën kujdesin e Komitetit të Nobelit, përkthimi i esesë së Gaston Parisit rreth Sully Prudhomme, u publikua në Francë në koleksionin "Mendimtarë e poet", shpërndarë në të gjitha libraritë suedeze, në të njëjtën ditë të dhënies së Çmimit Nobel.

Me modelin e epokës së vjetër ceremonia u organizua në sallën

e Festave, të Akademisë së Muzikës, zbuluar me shtylla ndriçuar magjishëm, gjithë lule, në praninë e përfaqësisë, të qeverisë dhe po ashtu zbuluar nga një pjesë e madhe fisnikësh. Gjithashtu më pas ceremonia u shoqërua nga një banket pritjeje gjithë hijeshi i të njëjtit nivel, ku buronte latinishtja me vargjet "Ad anniversarium primun institutionis Nobelianae" (Në përvjetorin e parë të Institucionit të Nobelit). Jetohej në atë epokë ku zinin vend fjalët e mëdha me frazat e gjata, të ngatërruara, të cilat përmblanin një amalgamë kuptimesh nga një anë ezoterike dhe po aq dehëse.

Çmimi i akorduar Sully Prudhomme në emër të tij dhe në emër të atdheut, u tërhoq nga Ministri Francës, zoti Marchand, ku "veshja e thjeshtë dhe demokratike", sipas komenteve të shtypit, "as një kordon në kostumin e tij të zi", nuk bënte kontrast para shkëlqimit të gjelbër suedeze.

Por çfarë mendonte vetë Sully Prudhomme i tërhequr në Francë ? Disa ditë më vonë i intervistuar nga një gazetar i "Le Figaro", ai shfaqej i gëzuar dhe i çuditur për çmimin që i ra si nga qielli, po ashtu dhe shuma pothuajse e njëjtë me ato që kishte fituar nga poezitë e tij, në këto tridhjetë e pesë vjet.

"Mendoj kolegët e mi të rinj, të cilët nuk kanë mundësinë të botojnë poezitë në fillimet e tyre. Kam dëshirën që një pjesë t'ua fal atyre që nuk mundën të botojnë librin e tyre të parë me poezi. Deri tani kam marrë një lumë kërkesash, shuma e të cilëve e kalon krejt Çmimin". Sully Prudhomme nuk ishte i pari që u çudit. E papritura nuk ishte po aq e vogël edhe në Suedi, ku çmimi i tij provokoi një reaksion të veçantë. Katër ditë pas shpalljes së çmimit, një peticion i firmosur nga 43 shkrimtarë dhe artistë të njohur me në krye Auguste Strindberg e Selma Lagerlof, publikuan:

"Leon Tolstoit, Me rastin e marrjes së çmimit Nobel të Letërsisë që iu akordua për herë të parë, ne të nënshkruarit, shkrimtarë, artistë dhe kritikë suedeze, dëshirojmë t'ju shfaqim habinë tonë. Ne nuk shohim në personin tuaj vetëm një patriark të nderuar të letërsisë moderne, por edhe një nga poetët më të mëdhenj që sipas mendimit tonë, duhej marrë në konsideracion, dhe pse ju vetë, personalisht, asnjëherë nuk keni kërkuar një shpërblim. Ne besojmë se është detyra jonë që t'ju drejtohem, pasi mendojmë se institucioni i ngarkuar për të dhënë çmimin në fjalë, duke parë përbërjen e tij aktuale, në asnjë moment nuk është shprehur në favor të artit, apo konform opinionit në përgjithësi. Nuk pranohet prej jashtë kufijve, arti i mendimit të lirë dhe krijimit të lirë e ky nga vetë ana e popullit të largët, nuk

është vlerësuar si më i miri dhe më i qëndrueshmi".

Sipas këtij dokumenti, mund të krijohet idea se Léon Tolstoi paraqiste në Suedi një rëndësi të madhe, i vetmi, dhe se vepra e tij kishte lënë gjurmë të thella në letërsinë e vendit. Por ja që nuk ishte kështu.

Ishte një klasik, dhe një simbol i pastër i cili stimuloi mendimin e pavarur në Rusinë e carëve, por asgjë më tepër. Përsa i përket Çmimit Nobel, ai krijonte një trampolinë të favorshme politike dhe një sulm kundër armikut të përjetshëm: Akademia suedeze. I moçmi i Jasnaia Polianas as nuk i shkonte mendja që do të përdorej si një instrument polemike, por nuk mund t'i shmangej simpatisë. Përgjigja e tij, drejtuar protestuesve suedeze, ishte karakteristike:

"Jam ndier shumë i kënaqur që nuk m'u dha Çmimi Nobel. E para, kjo do të më krijonte mjaft ngatërresa, të paturit e kësaj shume, para që sipas mendimit tim do të më sillnin vetëm të këqija, ngatërresa dhe e dyta, jam ndier i nderuar dhe i kënaqur pa masë, të shoh shprehjen e një simpatie kaq të madhe të figurave të rëndësishme dhe po ashtu të atyre që nuk i njoh fare". Pra, i pari Çmim Nobel nuk mori as vlerësime dhe as preference letrare. Nën dritën e përvojave këto dhjetë vitet e fundit, karakteri i saj zyrtar i lëvizjes internacionale të mirësjelljes është vënë mjaft në dukje.

Nderi nuk u bëhej aq poetëve melankolikë të epokës së Parnasse se sa Francës letrare që prej kohësh mbetet një stimulues i rëndësishëm.


Përgjatë ceremonisë, sekretari


elokuent dhe organizuesi i Çmimit, i dërgoi Akademisë franceze, një nderim "nga simotra e saj suedeze që ishte e lumtur t'i niste nga vendi i Tegner dhe Geijer, një dëshmi të nderuar, vendit i cili kishte parë lindjen e figurave si Racin, Corneille e Viktor Hygo".

Po kështu, në të njëjtën atmosferë pritej Çmimi Nobel i Sully Prudhomme. Akademia suedeze me kënaqësi dhe krenari hodhi në Gazetën Zyrtare "Journal Officiel", letrën e falenderimit të simotrës së saj franceze, letër kjo e firmosur nga Gaston Boissier: "I ngarkuar nga anëtarët e Akademisë franceze që me ftesën e Akademisë suedeze, ka propozuar me zgjedhjen e saj Sully Prudhomme, ju lutet ta falënderoni, në emrin e tyre, për çmimin që iu atribuua. Nderi i bërë, u mirëprit në gjithë vendin. Zoti Sully Prudhomme, është i vlerësuar dhe i dashur nga të gjithë për karakterin dhe talentin e tij. Ne i jemi mirënjohës dinjitetit të jetës së tij, vlerësimit të ndjenjave e mbi të gjitha të besimit ndaj çështjes së idealit, që ky çmim ka dashur t'ia vër në dukje.

Akademia franceze së cilës ai i përket prej njëzet vitesh, ndihet krenare për të; ajo i dërgoi në zyrën e tij ku është tërhequr për shkak të sëmundjes, falënderimet, e veçanërisht për rrezatimin që i transmtoi gjithë vendit. i lumturuar që me këtë rast, jam përçuesi i simpatisë së saj kundrejt një shoqërie letrare me të cilën ne ndihemi të bashkuar, dhe pse larg, nga një organizim i ngjashëm, nga përbërja e punës dhe i të njëjtit kult të letrave". /Exlibris

Përktheu nga frëngjishtja
Mimoza KUCHLY





**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Dumoshi: Salla e sportit në Istog përfundon në shtator

Ministrja Vlora Dumoshi të mërkurën e ka vizituar Istogun. Ajo ka inspektuar investimet që ka bërë MKRS-ja në këtë komunë. Ajo ka bërë me dije se Salla e Sportit në Istog do të përfundojë në muajin shtator. “Lajmi më i mirë është që një prej projekteve që është tejzgatur, salla e sporteve në qytet, po shkon drejt përfundimit dhe deri në shtator ky projekt do të kryhet”, ka thënë Dumoshi



Istog, 15 korrik - Salla e Sportit në Istog, projekt i cili ka nisur në vitin 2007, do të përfundojë në shtator të këtij viti. Në këtë projekt Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka investuar mbi 2.4 milionë euro. Këtë gjë e ka paralajmëruar ministrja e MKRS-së, Vlora Dumoshi, gjatë vizitës në Istog, kur për së afërmi ka përcjell investimet në të cilat po investon MKRS-ja në këtë komunë. Ministrja Dumoshi, e shoqëruar edhe nga zëvendësministri Engelbert Zefaj dhe një pjesë e stafit e MKRS-së, fillimisht është pritur nga kryetari i kësaj komune, Haki Rugova, me të cilin kanë diskutuar për projektet që po investon ministria në Istog si dhe mbarëvajtjen e tyre. Gjithashtu, kanë biseduar edhe për nevojat dhe për problemet që ka Komuna e Istogut, në resorët që i mbulon MKRS-ja dhe që janë të interesit të përbashkët. “Interesi i qeverisë dhe plani

programor i saj është i lidhur me zhvillimin e komunave të Kosovës. Në kuadër të kësaj, fushat e kulturës, rinisë dhe sportit, të cilat mbuloohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përmes investimeve të saj në komuna, janë konform këtij plani. Ndër marrëveshjet e para që kam nënshkruar si ministre me komunat, ka qenë me Komunën e Istogut. Lajmi më i mirë është që një prej projekteve që është tejzgatur, salla e sporteve në qytet, po shkon drejt përfundimit dhe deri në shtator ky projekt do të kryhet”, ka thënë ministrja Dumoshi, e cila ka folur edhe për projektet për sektorin e rinisë dhe i ka porositur drejtuesit e Komunës së Istogut që t'i inkurajojnë të gjithë të rinjtë e Istogut që të aplikojnë në programet që ka MKRS-ja për rininë, qoftë në programet e trajnimit për ndërmarrësi, në programet startup e të gjitha

thirrjet e tjera. Ministrja ka ribërë me dije se nga fondi pesë milionë euro që veç është paralajmëruar për MKRS-në, një pjesë do të ndahet edhe për rininë. “Si ministri do të angazhohemi në maksimum, duke bashkëpunuar edhe me komunat, që ta parandalojmë emigrimin e të rinjve jashtë vendit, duke krijuar kushtet që të rinjtë të zhvillohen dhe të avancohen në vendin tonë”, ka shprehur mendimin ministrja Dumoshi. Ndërsa kryetari Haki Rugova e ka falënderuar ministren për vizitën dhe për gatishmërinë e treguar për ta mbështetur me investime Komunën e Istogut, në projekte të cilat janë të nevojshme dhe në

dobi të qytetarëve të kësaj ane. “Dua ta falënderoj ministren Dumoshi për kujdesin ndaj Istogut sepse me marrjen e detyrës si ministre vizitën e parë e ka pasur në komunën tonë”, ka kujtuar kryetari Rugova. Ministrja Vlora Dumoshi ka inspektuar investimet të cilat po financon MKRS-ja në këtë komunë. Bëhet fjalë për Sallën e Qytetit në Istog, stadiumin “Demush Mavraj”, sallën e edukatës fizike në fshatin Vrellë, e që kalojnë vlerën financiare mbi një milion euro vetëm për vitin 2020 si dhe “Memorialin Ibrahim Rugova”, objekt multifunksional i cili do ta luajë edhe rolin e muzeut si një atrakcion turistik i këtij qyteti.

Gjatë vizitës në sallën e sportit të qytetit ministrja Dumoshi ka thënë se Istogu e meriton një sallë të këtillë sepse ka traditë, sidomos në sport dhe ka përmendur edhe basketbollistin e atletin e sportit, Fikret Shatri. “Sportistët e Istogut do të kenë një hapësirë moderne ku do të mund t'i zhvillojnë aktivitetet sportive dhe garat”, ka thënë ajo. Ndër projektet që do të përkrahen në Istog do të jetë edhe finalizimi i “Memorialit Ibrahim Rugova” të cilin ministrja pati rastin të vizitojë. Ministrja tha se MKRS-ja në Istog është duke investuar dhe financuar edhe në fushën e trashëgimisë dhe vetëm në këtë vit janë duke u zhvilluar tetë projekte në gërmime e në restaurime. “Memoriali Ibrahim Rugova” është një hapësirë e m r e k u l l u e s h m e multifunkionale e cila do të jetë në funksion për aktivitete të ndryshme kulturore dhe artistike. Ashtu siç u zotova në zyrën e kryetarit, bashkërisht do ta bëjmë konceptin muzeal, ku do të mund të ekspozohen eksponatet e ndryshme, pasi që Istogu, përpos që ka bukuri natyrore, është i pasur edhe me arkeologji”, ka theksuar ministrja Dumoshi, duke kujtuar se memoriali do të përfundojë me vënin e shtatores së presidentit Ibrahim Rugova, në qytetin e vendlindjes së tij.

Ademi: UEFA nuk e ka kërkuar dorëheqjen time



PRISHTINË, 15 NENTOR - Kryetari i Federatës së Futbollit e Kosovës, Agim Ademi, e ka mohuar se UEFA ka kërkuar që ai të japë dorëheqje nga posti i kryetarit të FFK-së. Ademi ka thënë se për rastin gjyqësor e ka informuar edhe UEFA-n. “Vazhdimisht kam qenë dhe jam në kontakt të drejtpërdrejtë me organet e UEFA-s dhe çdoherë jam

konsultuar për rastin tim gjyqësor dhe UEFA në çdo hap ka qenë e informuar mbi ecurinë e procesit. Përkundër faktit se e ndiej veten të pafajshëm, gjithmonë kam besuar në drejtësi dhe për këtë arsye e kam kërkuar të drejtën time legjitime deri në instancën e fundit gjyqësore, me ç'rast jam duke e pritur vendimin

përfundimtar. Për këtë është e informuar edhe UEFA, e cila asnjëherë nuk ka kërkuar dorëheqjen time”, ka thënë Ademi. “Organet e UEFA-s më kanë përkrahur në ushtrimin e funksionit tim dhe të kërkoj të drejtën time deri në fund të procesit. Këtë gjë ma kanë mundësuar edhe KE dhe të gjitha Lidhjet Rajonale të

Futbollit, me çka i falënderoj për mbështetjen dhe për mundësinë e dhënë. Prandaj, lajmet e tilla spekuluese kanë për qëllim destabilizimin e federatës dhe sjelljes në konfuzitet të klubeve, të njerëzve të futbollit dhe organeve të futbollit në fund të këtij edicioni futbollistik”, ka deklaruar Ademi.

Zekiqi: Liga Kosovë - Shqipëri të shfrytëzohet për zhvillimin e talenteve

PRISHTINË, 15 KORRIK - Federata e Basketbollit e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë janë duke punuar për jetësimin e ëndrës së shumë shqiptarëve për formimin e Ligës së Përbashkët. Në këtë ligë pritet të luajnë katër skuadrat më të mira nga Kosova dhe katër nga Shqipëria.

Komuniteti i Basketbollit në Kosovë e ka mirëpritur këtë ide të formimit të Ligës mes dy vendeve, sidomos nëse skuadrat u japin hapësirë lojtarëve të rinj. Kështu mendon edhe basketbollisti i Kosovës dhe Klubit Golden Eagle Ylli, Samir Zekiqi. “Është ide shumë e mirëseardhur. Është

shumë mirë që të kemi më shumë ndeshje. Shpresoj se në këtë ligë do të ketë hapësirë për lojtarët e rinj e të talentuar. Ata duhet të përkrahen maksimalisht dhe të kenë sa më shumë hapësirë. Klubet të punojnë për nxjerrjen e talenteve dhe të përfitojnë lojtari, klubi, por

edhe Përfaqësuesja”, ka thënë Zekiqi për faqen zyrtare të FBK-së. “Qëllimi i Ligës nuk duhet të jetë kryesor se kush do të shpallet kampion, por të dalin edhe lojtarë të rinj që kanë potencial dhe për disa vite me përkrahje, të arrijnë sa më lart dhe të përfitojnë të gjithë së bashku, si lojtari,



klubi, por edhe kombëtaret”, ka deklaruar Zekiqi.

KH Prishtina konfirmon pjesëmarrjen në garat evropiane

Prishtinë, 15 korrik - Skuadra e Prishtinës në hendboll për meshkuj ka konfirmuar se këtë edicion do të jetë pjesë e garave evropiane. Nënkampioni i Kosovës do të marrë pjesë në EHF European Cup. "Me

shumë kënaqësi ju njoftojmë se klubi ynë, KH Prishtina, edhe zyrtarisht do të jetë pjesë e garës EHF European Cup. Kundërshtari i Prishtinës do të kuptohet në muajt në vazhdim. Pjesëmarrja në garat

evropiane vjen si rezultat i punës së palodhshme të kryetarit Kolgeci, drejtorit Cela dhe angazhimit maksimal të të gjithë stafit teknik dhe lojtarëve në sezonin tanimë të përfunduar 2019/2020. Tani,

më shumë se kurrë, klubi ynë shpreson se do ta ndihmojnë sponsorët, individët e ndryshëm e, mbi të gjitha, Komuna e Prishtinës, për garat evropiane", thuhet në njoftimin e klubit kryeqytetas.



Qëndrim Gashi kërkohet nga tri skuadra elitare të Kosovës dhe një evropiane

PRIZREN, 15 KORRIK - Ylli i Lirisë, Qëndrim Gashi, që gjysmën e sezonit të kaluar e kaloi në fanellën e Vushtrrisë, është një ndër lojtarët më të kërkuar nga skuadrat elitare të Superligës së Kosovës. Gashi për "arbresh.info" ka thënë se për të ky edicion ka qenë ndër më të mirët shkaku që i konkurrencës së ashpër për titull. "Edicioni i këtij viti ka qenë dhe është një ndër edicionet më të mira në vitet e fundit në futbollin tonë, sepse ka pasur konkurrencë të ashpër për titull", ka thënë Gashi.

Ndërsa gjëja më e keqe, sipas tij, është mungesa e tifozëve, ngase derbit më të mëdha janë duke u zhvilluar me dyer të mbyllura. "Mund të them se gjëja negative e këtij edicioni është paraqitja e Covid-19 për shkak se mungojnë tifozët në stadione dhe ndeshjet më interesante janë duke u zhvilluar pa tifozë", ka shtuar Gashi.

I pyetur për të ardhmen, Gashi theksoi se synimi kryesor mbetet të luajë në Evropë. "Synimi im kryesor në të



ardhmen është që të luaj në Evropë", ka deklaruar ylli i Lirisë. Gashi në fund zbuloi se kërkohet nga tri skuadra elitare dhe një skuadër nga Evropa, kurse gjatë ditëve në vazhdim do ta marrë vendimin përfundimtar. "Për momentin jam në pushime dhe po punoj maksimalisht që të jem i gatshëm për sezonin e ri.

Kontrata ime me Lirinë ka përfunduar, ndërsa jam në bisedime me tri skuadra nga Superliga e Kosovës dhe një jashtë vendit. Gjatë ditëve të ardhshme do të vendos për të ardhmen", ka pohuar Gashi, i cili ka qenë në të gjitha grupmoshat e Përfaqësueses së Kosovës: U15, U17, U19 dhe U21.

Rossi: Jam gati për sezonin e ri

JEREZ DE LA FRONTERA, 15 KORRIK - Piloti italian Valentino Rossi shprehet i kënaqur që pas një pushimi kaq të gjatë do të rikthehet në pistë. Ditën e diel, në pistën e Jerez (Spanjë), nis sezoni 2020 i Moto GP. Ky është sezoni i fundit i Rossit me motorin Yamaha. "Më në fund rikthehem në pistë, pasi më ka munguar kjo ndjesi", ka thënë Rossi. "Do t'i nisim testet e para në këtë pistë dhe të shohim se si është gjendja. Në testet e kryera në Sepang dhe Losail u paraqitëm mirë, por që nga ajo kohë kanë kaluar disa muaj. Na duhet të gjejmë një harmoni në pistë me motorin e ri. Gjithsesi, unë jam gati për sezonin e ri", është shprehur Rossi.

Legjenda e Moto GP shprehet se ka një ndjesi të mirë për



këtë sezon, teksa garon për titullin e 10 kampion në karrierën e tij. "Testet dimërore i mbyllëm mirë, ndaj kam një ndjesi pozitive. Jerezi

është një pistë ndryshe dhe vendimtar në këtë fillim sezoni për të fituar do të jetë përshtatja pas një pushimi kaq të gjatë", ka deklaruar Rossi.

SHKURT

WBA-ja ofron 22 milionë euro për Muriqin

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, mund ta vazhdojë karrierën në futbollin anglez. Klubi i ri i Premierligës, West Bromwich Albion, është i gatshëm t'i ofrojë 22 milionë euro për sulmuesin e Fenerbahçes. E përditshmja turke "Sabah" raporton se klubi anglez i ka ofruar 22 milionë euro për Muriqin. Tash i mbetet Fenerbahçes të vendosë nëse do ta pranojë apo jo këtë ofertë. Fenerbahçe duhet t'ia japë 15-përqindëshin e kësaj shumë ish-klubit të Muriqit, Rizespor. Muriqi ka kontratë me Fenerbahçen deri në vitin 2023.

Gjasula mund të kalojë në Hamburg

Mesfushori i Shqipërisë, Klaus Gjasula, mund të gjejë shumë shpejt skuadër. Ish-lojtari i Padërbornit mund të firmosë me klubin e Hamburgut. Sipas "Sport1", 30-vjeçari mund të transferohet me parametër zero te skuadra e njohur gjermane, pasi nuk rinovoi kontratën me Padërbornin, që ra nga elita e futbollit gjerman. Gjasat janë që Gjasula të firmosë për dy vjet me Hamburgun dhe është gati ta ndihmojë ekipin në ngjitje drejt Bundesligës.

Tre yjet që synohen nga City

Pas heqjes së dënimit të UEFA-s nga Gjykata e Arbitrazhit Sportiv, Manchester City është gati të ndërhyjë në merkaton verore. Trajneri Pep Guardiola do të vijojë të jetë në krye të stolit dhe për të pritet të ketë edhe transferime të reja. I pari në listën e Cityt është sulmuesi i Interit, Lautaro Martinez. Mas pas në listë është mbrojtësi i Napolit, Kalidou Koulibaly, ndërsa për krahum e majtë Pep Guardiola e dëshiron Davin Alaban, me të cilin ka punuar edhe në kohën kur e ka drejtuar Bayern Munchenin.

Edhe një basketbollist i infektuar në NBA

Numri i basketbollistëve të infektuar me Covid-19 në NBA vazhdon të rritet. Harrison Barnes i Sacramento Kingsit është basketbollist i fundit i testuar pozitiv në testin për koronavirus. Lajmin e ka konfirmuar vetë basketbollisti në rrjetet sociale. Ai ka thënë se është asimptomatik, por është futur në izolim duke respektuar protokollin e sigurisë. Barnes do t'i bashkohet ekipit të Sacramentos në Orlando pasi të shërohet nga Covid-19.

Umtiti, afër largimit nga Barcelona

Samuel Umtiti është afër që të largohet nga Barcelona. Ai është transferuar nga Lyoni në vitin 2016, por nuk bën pjesë në planet e skuadrës për të ardhmen. Interesim për francezin kanë shprehur klubet italiane si Lazio, Napoli, Roma dhe Torino. Interesim për 26-vjeçarin ka treguar që një kohë të gjatë edhe Arsenal. Umtiti është pjesë e rëndësishme e Kombëtares së Francës me të cilën ka regjistruar 31 paraqitje dhe ka shënuar katër gola.

Kupa e Botës fillon më 21 nëntor

FIFA ka dalë me një njoftim zyrtar se kur do të zhvillohet Kupa e Botës e vitit 2022. Tashmë është konfirmuar se Katar është nikoqir i evenimentit më të madh në botën e futbollit. Shtëpia e futbollit botëror bëri të ditur se ky eveniment do të fillojë më 21 nëntor të vitit 2022 dhe do të përfundojë më 18 dhjetor të po atij viti. Këto data janë caktuar shkaku i të nxehtit të madh që mbretëron atje dhe nuk mund të zhvillohet në muajt e verës. Ka pasur kritika ndaj organizatorëve se punëtorët që merren me ndërtimin e stadioneve po punojnë në temperatura të larta dhe nuk po trajtohen mirë. FIFA kishte reaguar me inspektim të punimeve dhe punëtorët nga atëherë punojnë vetëm kur temperaturat janë më të ulëta. Kështu, nga kjo rrjedhë është marrë edhe vendimi që Kampionati Botëror të zhvillohet kur temperaturat janë më të ulëta atje, derisa në shumë vende të botës fillon sezoni i dimrit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republik of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opština Dragaš /
Daragas Municipality



Në bazë të nenit: 7, 8, 10 paragrafi 1, nënparagrafi 2.1, dhe 2.2 nenit: 15, paragrafi:1,2 dhe 3 të Ligjit të Punës nr: 03/L-212, nenit 5 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, dhe U.A. nr: 7/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik dhe duke u bazuar dhe në kërkesen e Drejtorit të Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare në Dragash nr.02.111/01-10113 „Shërbimi i Personelit shpallë këtë ;

KONKURS

Titulli i punës: Doktor i Mjekësisë (H-Doctor-non specialist H-27)

Njësia: QKMF-Dragash,QMF dhe në AMF

Niveli i pages ;GRIST H-mjek-GP

Kontrata: dymbdhjet muaj me mundësi vazhdimi

Orari i punës : Me orar të plotë (40 orë në javë).

I raporton:-Drejtorit të QKMF-së

-Kualifikimet

-Fakulteti i Mjekësisë /Drejtimi i përgjithshëm- Licenca nga Ministria e Shëndetësisë .

Vertetimi qe nuk eshte nen hetime nga Gjykata ,

Vertetimi nga Policia që nuk ka te kaluar kriminale.

Dokumentet dhe shkathtësit e kërkuara.

-Licenca e punës,Certifikatë e lindjes ,kopje të dokumentit identifikues

-Njohja e punës me kompjuter

-Njohja e gjuheve zyrtare

-Të posedoj aftësi dhe shkathtësi profesionale për të punuar në shoqëri multietnike

Detyrat dhe pergjegjësitë

- Përciellë zhvillimet në mjekësi përmes qasjes për aftësim të vazhduar profesional.
- Evidenton dhe paraqet rastet e smundjeve infektive sipas rregullave të ISHP.
- Bënë vizitën,kujdesin dhe shërimin e pacientit .
- Kryen vizita sipas nevojës edhe jashtë institucionit për pacientët e semur kronik,
- Referon pacientet në shërim të kujdesit sekundar ose terciar
- Bënë diagnostifikimin dhe përcakton terapinë,
- Mbanë kujdestarinë sipas orarit të caktuar në QKMF dhe sipas nevojave dhe në QMF..
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrave të Drejtorit të QKMF-së.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit .

Formularët për aplikim mund të marrën në Zyren e personelit të KK Dragashit-zyrja nr.9.dhe të kompletuara dorzohen në zyren e primit K.Dragash.

Aplikacionet e dërguara pasë dates së fundit si dhe ato të pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

Shërbimi i Personelit



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republik of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragaš / Daragas Municipality



Në bazë të nenit: 7, 8, 10 paragrafi 1, nënparagrafi 2.1, dhe 2.2 nenit: 15, paragrafi:1,2 dhe 3 të Ligjit të Punës nr: 03/L-212, nenit 5 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, dhe U.A. nr: 7/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik dhe duke u bazuar dhe në kërkesen e Drejtorit të Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare në Dragash nr.02.111/01-10115, Shërbimi i Personelit shpallë këtë ;

KONKURS

Titulli i punës: Mjek Stomatolog (H-Doctor-non specialist H-26)

Njësia: QKMF-Dragash,QMF dhe në AMF

Niveli i pages ; H-Doktor-Dentist

Kontrata: 12 muaj me mundësi vazhdimi

Orari i punës : Me orar të plotë (40 orë në javë).

I raporton:-Drejtorit të QKMF-së

Kualifikimet

Fakulteti i Mjekësisë – Drejtimi i Stomatologjisë Licenca nga Ministria e Shëndetësisë.

Certifikata qe nuk eshte nen hetime nga Gjykata ,

Vertetimi nga Policia që nuk ka te kaluar kriminale.

Dokumentet dhe shkathtësit e kërkuara.

-Licenca e punës,Certifikatë e lindjes ,Kopje të dokumentit identifikues,

-Njohja e punës me kompjuter,

-Njohja e gjuheve zyrtare,

-Të posedoj aftësi dhe shkathtësi profesionale për të punuar në shoqëri multietnike,

Detyrat dhe pergjegjësitë

1. Bënë ekzaminimin e parë dhe të përsëritur të sëmureve nga lemija e shëndetit oral.
2. Promovon edukimin shëndetësor oral;
3. Jep udhëzime me shkrim dhe gojë për trajtim të pacientit;
4. Kujdeset për mjetet e punës, Kontrollon punën e asistentit/es,
5. Ordinon preparate me flore për femije dhe shtatzëna;
6. Bënë mjekimin e dhëmbëve dhe nxjerrjen e tyre, si dhe heqjen e depozitimeve të forta dhe të buta nga dhëmbi;
7. Kryen diagnostikimin, nxjerrjen, shërimin ,mbushjen dhe mbylljen e kanaleve të dhëmbëve.
8. Jep udhëzime për intervenime të ndërlikuara të stomatologjisë specialist ose klinike.
9. Kujdeset për mirëmbajtjen e karriges stomatologjike dhe pajisjeve përcjellese të sajë.
10. Mban evidencen e furnizimit dhe të shpenzimit me material shpenzues stomatologjik .
11. Kryen edhe punë tjera nga fusha e stomatologjisë në punkte tjera shëndetësore në Dragash, me kërkesen e menaxherit dhe drejtorit të QKMF-se

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit .Formularët për aplikim mund të marrën në Zyren e personelit të KK Dragashit-zyrja nr.9.dhe të kompletuara dorzohen në zyren e primit K.Dragash.

Aplikacionet e dërguara pasë dates së fundit si dhe ato të pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

Shërbimi i Personelit



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opština Dragaš / Dragas Municipality



Na osnovu člana: 7, 8, 10 stav 1, podstav 2.1 i 2.2, član 15, stav: 1,2 i 3 Zakona o radu br: 03 / L-212, člana 5 Ugovora o kolektivnog zdravlja, i AU br: 7/2017 o regulisanju postupaka za osnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, na osnovu zahteva direktora Glavnog Centra Porodične Medicine u Dragašu broj 02.111 / 01-10113, Kadrovska Služba objavljuje ovaj;

KONKURS

Radno mesto: Doktor Medicine – (H-Doctor-non specialist H-27)

Jedinica: GCPM-Dragash, CPM i APM

Nivo plate: H-doktor -GP

Ugovor: 12 meseci sa mogućnošću nastavka

Radno vreme: Puno radno vreme (40 sati nedeljno).

Izveštava: Direktor GCPM -a

Kvalifikacije

-Fakultet medicine / opšti smer- Licenca iz Ministarstva Zdravlja

-Potvrda da nije pod istragom Suda

-Potvrda policije da nema krivičnu prijavu.

Potrební dokumenti i veštine.

-Licenca rada, Izvod rođenih, kopija ID-a (lične karte),

-Poznavanje rada na računarima

- Poznavanje Zvaničnih jezika

- Da poseduje profesionalne veštine i veštine za rad u multietničkom društvu.

Dužnosti i odgovornosti

- Praćenje razvoja u medicini kroz pristup stalnom stručnom usavršavanju.
- Identifikuje i predstavlja slučajeve zaraznih bolesti prema pravilima ISHP-a.
- Obavlja posetu pacijenata, negu i lečenje.
- Vrší posete po potrebi izvan ustanove za hronično bolesne pacijente,
- Šalje pacijente na lečenje sekundarne ili terciarne nege
- Vrší dijagnostiku i određivanje terapije,
- Vrší dezurstva prema vremenskom rasporedu u GCPM-u i prema potrebama i CPM-u.
- Vrší i ostale dužnosti prema uputama direktora GCPM-a.

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Obrazac za prijavu se može dobiti u Kancelariji Kadrovske službe u Dragašu broj 9,i popunjenu predaje se u prijemnoj kancelariji O.Dragas.

Aplikacije poslate posle isteka datuma kao i nedovršene neće biti pregledane.

Kadrovska služba



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragaš / Dragas Municipality



Na osnovu člana: 7, 8, 10 stav 1, podstav 2.1 i 2.2, član 15, stav: 1,2 i 3 Zakona o radu br: 03 / L-212, člana 5 Ugovora o kolektivnog zdravlja, i AU br: 7/2017 o regulisanju postupaka za osnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, na osnovu zahteva direktora Glavnog Centra Porodične Medicine u Dragašu broj 02.111 / 01-10115, Kadrovska Služba objavljuje ovaj;

KONKURS

Radno mesto: Doktor Stomatologa – (H-Doctor-non specialist H-26)

Jedinica: GCPM-Dragash, CPM i APM

Nivo plate: GRIST H-Mjek- Stomatolog

Ugovor: 12 meseci sa mogućnošću nastavka

Radno vreme: Puno radno vreme (40 sati nedeljno).

Izveštava: Direktor GCPM -a

Kvalifikacije

Fakultet medicine - Smer stomatologije, Licenca iz Ministarstva Zdravlja.

Potvrda da nije pod istragom Suda

Potvrda policije da nema krivičnu prijavu.

Potrební dokumenti i veštine.

-Licenca rada,Izvod rođenih, kopija ID-a (lične karte),

-Poznavanje rada na računarima

- Poznavanje zvaničnih jezika

- Da poseduje profesionalne veštine i veštine za rad u multietničkom društvu.


Dužnosti i odgovornosti

1. Radi prvi pregled pacijenata u oblasti oralnog zdravlja;
2. Promoviše oralno zdravstveno obrazovanje;
3. Daje pismena i usmena uputstva za lečenje pacijenta;
4. Vodi računa o radnim alatima, kontroliše rad asistenta,
5. Ordinira preparatima sa florom za decu i trudnice
6. Vrší lečenje zuba i vađenje zuba, vađenje čvrstih i mekih depozita iz zuba;
7. Vrší diagnostifikaciju, vađenje, lečenje, punjenje i zatvaranje kanala zuba;
8. Daje uputstva za komplikovane intervencije za stomatološkog specijalistu ili kliniku;
9. Brine se o održavanju stomatološke stolice i njenu prateću opremu;
10. Vodi evidenciju nabavke i troškova potrošnog stomatološkog materijala;
11. Vrší i ostale poslove sa polja stomatologije u ostalim zdravstvenim punktovima u Dragašu na zahtev menadžera ili direktora GCPM-a

Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja.Obrazac za prijavu se može dobiti u Kancelariji Kadrovske službe u Dragašu broj 9.i popunjenu predaje se u prijemnoj kancelariji O.Dragash.


Aplikacije poslate posle isteka datuma kao i nedovršene neće biti pregledane.

Kadrovska služba



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Adem Gashini shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Ekrem Rexha Drini " Lubizhd.

► Myrvete Kalumashi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Hadmir Kryeziu shpall të pavlefshme dëftesat e vitit I, II shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Ajran Thaqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Avdyll Frasheri " Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa e ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihen çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gjiçan Beledijesi

DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës nën 5 pika e, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nën 35, dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr 07/2017, për Rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria e Arsimit në Gjiçan shpallë këtë:

**KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

I. Institucionet Parashkollore (IP)

1. IP "Dardania" në Gjiçan
 - Një Edukatorë/e për fëmijë me nevoja të veçanta
2. IP "Integj" në Gjiçan
 - Një Edukatorë/e
3. IP "Ardhmëria I" në Gjiçan
 - Një Edukatorë/e, zëvendësim pushim i lehonisë deri më datën 31.12.2020

II. Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta (SHFMU)

1. SHFMU "Selami Hallaqi" në Gjiçan
 - Një mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë Gjermane, pushim i lehonisë deri më datën 28.02.2021
2. SHFMU "Liria" në Pogradec
 - Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor (paralele e ndarë në Llovçë), me kohë të caktuar deri më 31.08.2021
 - Dy mësimdhënës/e të Ciklit Klazor (paralele e ndarë në Bilinje), me kohë të caktuar deri më 31.08.2021.
 - Një mësimdhënës i lëndës së edukatës fizike 16 orë, deri më datën 31.08.2021
 - Një mësimdhënës i lëndës së arti figurativ 8 orë me plotësim norme në SHFMU "Dëshmorët e Kombit" 8 orë, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021
3. SHFMU "Agim Ramadani" në Zhegër
 - Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor, pushim i lehonisë deri më datën 15.11.2020
 - Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor, pushim i lehonisë deri më datën 28.02.2021
 - Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor, pushim pa pagesë deri më datën 31.08.2021
 - Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor, deri më 31.08.2021 paralelen e ndarë Selishtë
4. SHFMU "Abaz Ajeti" në Gjiçan
 - Tre mësimdhënës/e të Ciklit Klazor, me kohë të caktuar deri më datë 31.08.2021
5. SHFMU "Musa Zajmi" në Gjiçan
 - Një mësimdhënës të ciklit klazor, me kohë të caktuar deri më datë 31.08.2021
6. SHFMU "Veseli Muja" në Mihir
 - Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor (paralele e ndarë në fshatin Ponesh), me kohë të caktuar deri më 31.08.2021
7. SHFMU "Ibrahim Uruqi" në Bresale
 - Një mësimdhënës/e për lëndën e fizikës 16 orë
 - Dy mësimdhënës të Ciklit Klazor, me kohë të caktuar deri më datë 31.08.2021
 - Një mësimdhënës i lëndës së arti figurativ, pushim pa pagesë
8. SHFMU "Bajram Curri" në Shurdhan
 - Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021.
 - Një mësimdhënës/e për lëndën e Gjeografisë 7 orë dhe 3 orë Ed.qytetare, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021.
9. SHFMU "Nazim Hikmet" në Dobërçan
 - Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor (paralele e ndarë në Bukovik), me kohë të caktuar deri më 31.08.2021.
 - Një mësimdhënës/e për lëndën e Matematikës (16 orë në paralelën e ndarë në Bukovik) me kohë të caktuar deri më 31.08.2021
 - Një mësimdhënës i lëndës së gjuhës gjermane 16 orë, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021.
 - Një mësimdhënës i lëndës së Kimisë 6 orë, Biologji 6 orë dhe Fizikë 8 orë paralelja e ndarë turke në kohë të caktuar deri më 31.08.2021
 - Një mësimdhënës/e për lëndën e Kimisë për 10 orë, në vend të drejtorit të shkollës
10. SHFMU "Afërdita" në Kishnapole
 - Dy mësimdhënës/e të Ciklit Klazor, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021 paralelen e ndarë Sllakoc
 - Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor – Një mësimdhënës/e në paralelën e ndarë në Gadish, në kohë të caktuar deri më 31.08.2021
 - Një mësimdhënës i lëndës së Fizikës 10 orë, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021 paralelën e ndarë Sllakoc
 - Një mësimdhënës i lëndës së Matematikës 10 orë, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021 paralelën e ndarë Sllakoc
11. SHFMU "Ramiz Çërrnica" në Çërrnicë
 - Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor (paralele e ndarë në Kravariçë), me kohë të caktuar në vende të drejtorit të shkollës
 - Dy mësimdhënës/e të Ciklit Klazor, me kohë të caktuar, 31.10.2020 zëvendësim pushim i lehonisë
 - Një Edukatorë/e për klasën para fillorë
 - Një mësimdhënës/e për lëndën e Historisë, me kohë të caktuar, 31.08.2021

12. SHFMU "Vatra e Diturisë" Livoq i Epërm

- Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021.
- Një mësimdhënës i lëndës së biologjisë 14 orë, deri më datën 31.08.2021
- Një mësimdhënës i lëndës së TIK-ut 10 orë, me plotësim norma 8 orë në SHFMU "Ramiz Çërrnica" me kohë të caktuar deri më 31.08.2021

13. SHFMU "Rexhep Elmazi" në Gjiçan

- Një mësimdhënës/e për lëndën e arti figurativ për 17 orë, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021.
- Dy mësimdhënës/e të Ciklit Klazor, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021.

14. SHFMU "Dëshmorët e Kombit" në Livoq të Ulët

- Një mësimdhënës i lëndës së biologjisë për 16 orë, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021
- Një mësimdhënës i mësimi klazor, zëvendësim, pushim i lehonisë deri më datën 30.04.2021

15. SHFMU "Sadullah Brestovci" në Gjiçan

- Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021

16. SHFMU "Esat Berisha" në Llashticë

- Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor nga data 01.11.2020, zëvendësim pushim i lehonisë
- Një mësimdhënës/e të Ciklit Klazor nga data 01.12.2020, zëvendësim pushim i lehonisë
- Një mësimdhënës/e Artit Figurativ për 10 orë, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021

17. SHFMU "Feta Qerimi" në Vërbicë të Zhegocit

- Dy mësimdhënës/e i lëndës së matematikës nga 15 orë, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021
- Një mësimdhënës/e për lëndën e Gjuhës Shqipe për 19 orë, me kohë të caktuar vende të drejtorit të shkollës

III. Shkolla e Mesme e Lartë (SHML)

1. SH.M.E. "Marin Barleti" në Gjiçan

- Një mësimdhënës/e për lëndën e psikologjisë, zëvendësim pushim i lehonisë për 10 orë deri më 28.02.2021
- Një mësimdhënës/e për lëndën e TIK-ut për 14, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021

2. SH.M.L. "Adem Kastrati"

- Një mësimdhënës i lëndës së tekstit për 16 orë deri më datën 31.08.2021

3. SH.M.M. "Aslan Elezi" Gjiçan

- Një mësimdhënës i lëndës mjekësore 20 orë, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021
- Një mësimdhënës i lëndës mjekësore 12 orë, me kohë të caktuar deri më 31.08.2021

Vërejtje: Kontratat e punës përveç atyre që janë pushim i lehonisë dhe pushim pa pagesë lëshohen deri më 31.08.2021. Pas skadimit të këtyre kontratave për këto vende të punës, Drejtoria Komunale e Arsimit në cilësinë e punëdhënësit do të bëjë një analizë të tepricave të mësimdhënësve që mund të ketë për vitin shkollor 2021/2022, në rast se nuk paraqiten teprica të mësimdhënësve, nëpunësve të pranuar do t'iu vazhdohet kontrata e punës në ato shkolla.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT (UA Nr.10/2018) Udhëzimin Administrativ MASHT, nr.05/2015 Normativ për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional si dhe procedurave të përcaktuara për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kualifikimi për Edukatorë/e dhe Mësimdhënës/e: kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit të MASHT-it në fuqi. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ të MASHT-it, nr. 12/2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Për vendet e punës në fjalë nevojiten këto dokumente: diploma mbi përgatitjen profesionale, kopja e letërnjoftimit, vërtetim mbi përvojën e punës, certifikatën e lëshuar nga sektori gjendjes civile me të cilin dëshmohet vendbanimi i kandidatit, vërtetimi nga gjykata kompetente se personi nuk është nën hetime. Të gjitha duhen të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga shpallja në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më 16.07.2020 deri më datë 30.07.2020 (ora: 16:00).

Komisioni do të bëjë selektim të aplikacioneve dhe në intervistë ftohen vetëm ata kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe në pajtim me normativet në fuqi.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Gjiçan.

Kandidatët të cilët aplikojnë më shumë se një shkollë, mund të aplikojnë vetëm me një formularë të aplikimit duke i cekur emrat e shkollave ku aplikon.

Sqarim:

Për këto vende të punës, kandidatët duhet t'i nënshtrohen testit me shkrim. Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimit i cili do të publikohet në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në objektin pranë Qendrës për Shërbim të Qytetar.

Vërejtje: Për shkak të rrethanave të Pandemisë – Covid 19, Testi me shkrim dhe Intervista me gojë do të realizohen sipas Rekomandimeve dhe Udhëzimeve të IKSHP (Instituti Kombëtar të Shëndetit Publik) dhe MSII (Ministritë së Shëndetësisë).

Drejtori:
Nazmi Gagica

